

BIBLIOTEKA
SHTETIT

034-2

323

TREGIME HUMORISTIKI

NDINI
BARDHI



KUR ME ZURI
SEVDAJA

85H-2
B 27

NDINI BARDHI

KUR MË ZURI SEVDAJA

Tregime humoristike



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

E PO... GEZUAR O KRUSHK!...

Pashë mirë orarin e pritjes dhe trokita me kujdes. Pas një fare kohe zëri nga brenda më njoftoi se lejohesha të hyja. Ashtu bëra. Në krye të dy tavolinave të vendosura në formë T-je qëndronte personi, të cilit do t'i drejtoja kërkesën time. Rrinte ulur, i mbytur në shkresa, me vetulla të varura, i zymtë. Ai, pa e ngritur kokën, me një shenjë të lehtë të dorës, më ftoi që të ulesha. Dhe unë zura vend në një karrige sa më pranë tij. Qetësi. Ra telefoni. Zyratari mori receptorin me përtesë.

— Urdhëro... po... po... si?!!... Këtu ai kërceu përpjetë.

— Pse?... Me urdhër të kujt vepruat kështu...

Zëri i tij metalik gjëmonte. Damari i ballit iu ngrit si një krimb misri. Në fund, prerazi, mbasi dha urdhrat e tij të «nxehta» dhe si e paralajmëroi që të mos bëheshin më lojëra të tilla me urdhrat, përplasi receptorin duke murmuritur: «dreqi ju marrtë!». Pastaj u kthye nga unë:

— Po ti?

— Unë?

— E ore ti, po kush, unë?

— Kam një kërkesë, por nuk e di në të gjeta në orë të mirë.

Bashkëbiseduesi ngriti kokën dhe më shikoi me dyshim:

Cilën quan ti, shok, orë të mirë? Me sa di unë të gjitha orët e orarit zyrtar janë shumë të mira, gjithë punë, rendiment.

— Nuk më kuptuat — i thashë — e kisha fjalën pér njerinë nëse ndodhet me humor ose jo...

— A, të lutem shumë, këtu s'ka vend pér humor. Kur jemi në punë gjithçka do t'ia nënshtrojmë asaj, sepse kështu ne përbushim detyrat që na kanë caktuar dhe justifikojmë sado pak emrin «shërbëtorë të popullit», siç na thërresin, apo jo?

— Po, xhanëm ashtu është... u tërroq a unë dhe, aty pér aty, vendosa që të mos ia jepja një letërrekomandimi nga baxhanaku i tij.

— Urdhëro! Si e ke hallin? — pyeti përsëri me seriozitet. Ia tregova me pak fjalë çështjen që më preokuponte dhe ai dëgjoi, ashtu në heshtje, pa më ndërprerë, pastaj më bëri një pyetje lalonike:

— Domethënë, automjetet tuaja vonohen pér shkarkim në depot tonë! Ju kam kuptuar mirë?

— Pikërisht!

— Dhe ju doni të përmbysjet kjo praktikë?

— Ndoshta gjer atje jo, por, si të them, gjithë këto vonesa...

Ai më foli sa mbaroi orari zyrtar pér parimin, me një saktësi të habitshme, pastaj pa orën, duke më dhënë këshillat e fundit, d.m.th. të mos kërkoja gjëra të pamundura. Ajo që bëhej, bëhej, po ajo që s'bëhej, s'bëhej dhe pikë. Unë e kundërshtova.

— Më duket se me një organizim më të mirë të punës — i thashë — dhe pa cenuar parimin, bile, bile duke i respektuar ca më mirë ato, ky difekt rregullohet pér bukuri dhe shteti ka ç'fiton.

— Kam njëzet vjet me direktiva e ligje nëpër duar. Organizimin e punës e njoh më mirë nga ti, prandaj, në qoftë se ke ardhur për të më treguar arat... — Vendosa të përdor gurin e fundit. Nxora letrën:

— Nejse, u pa puna ime, po harrova t'ju jap një shënim nga baxhanaku juaj.

— Sadushi?! — u çudit ai. — Pse, ku e njeh Sadushin ti?

— I vëllai i Sadushit, me sa duket, po kurdis telat me një kushërirën e parë timen.

— Si kështu, po ne qenkeshim krushq, apo jo?

— Kështu më duket — buzëqesha unë krushqërisht.

— Po si jeni?! — pas dy orësh, bashkëbiseduesi po më jepte dorën, për të më misardhur. Besoj që ky ishte një rast i rrallë. Së paku për mua, pa ky kështu mund të sillet me të gjithë.

— Faleminderit, juve mirë jeni?

— Atë krushqëri si e kam, gjithë mirë?

— Shumë mirë, të bën të fala.

— Faleminderit, gëzohem që u njohëm... Ai u zhyt në leximin e letrës. Gjatë leximit të saj vura re se si mund të marrë njeriu dy fytyra brenda një sekonde. Ja, tani krushku qëndronte para meje me një pamje të hareshme.

— U gëzova me të vërtetë që u njohëm, se ndodh... oj ndodh, them,.. nuk them ka bërë vaki, që dy krushq u rrahën me dacka atje në një dyqan frutash... po më mirë dalim nga kjo djall zyre, se më mori frymën. Pimë ndonjë kafe. Atje ta tregoj unë si u zunë dy krushq.

Shkuami për kafe, por në vend të saj më vunë përpëra një gotë raki me ç'i duhen asaj pas.



— Ku e kishim fjalën?... ah po, tek zënka e dy krushqve. Në një dyqan frutash të dy krushqit, që nuk mbanin mend njëri-tjetrin, u rrahën me dacka, gjersa vajti puna në polici. Kur oficeri i shërbimit i pyeti për emrat dhe banimin e tyre, njohën njëri-tjetrin dhe u përqafuan, pas gjithë atyre dackave

që kishin këmbyer pak më parë!.. Ja, pra, që njeriu duhet të njohë gjithë njerëzit. Edhe ne kështu desh e bëmë.

— Vegse jo në një dyqan frutash, por në zyrë.

— Nejse, puna po aty del.

— Jo, unë e kam tek vonesat në ngarkim-shkar-kim...

— E mora vesh, e mora! Hajde, gëzuar!

— Gëzuar...

Gotat e rakisë pasonin njëra-tjetrën dhe krushku im e kishte flakur atë rrobën e zyrtarit të ftohtë duke u transformuar në një krushk gojëmbël dhe të dashur. Unë, si me frikë, ia kujtova edhe një herë problemin për të cilin kisha ardhur. Ai qeshi.

— Dëgjo, krushk, të kegen! Një njeri po nuk deshi dhe po nuk ndihmoi njerëzit e tij, ai s'do as shqërerinë as... çfarë të them, ti e merr me mend vetë.

— Po unë e kam litarin në fyt me automjetet — i thashë tashmë me kurajo.

— Pse, si e ke hallin ti? — pyeti ai duke më lënë gojëhapur mua, mbasi ia kisha spjeguar çështjen atje në zyrë plot dy orë.

— Po ja, atë çështjen që biseduam në zyrë.

— Ohuaaa! Sa më vijnë në zyrë mua, po të gjithë krushq nuk i kam unë, or de! — dhe më shkelli syrin. — Zyra ka punën e saj...

— Po, po, ashtu është, xhanëm — fola me miratim dhe nisa t'ia spjegoja edhe një herë.

— Aaa! M'u kujtua, — më ndërpreu ai. — Hiç mos e vra mendjen. Këtë punë e mbaroj unë...

— Më rrofshë, o krushk, gëzuar, të paça!

— Po, po, kur marrë unë përsipër diçka, i vë shpatullat e mia. Nuk di të turpërohem unë!

- Po, po, xhanëm, burrat kështu bëjnë.
 — Ashtu de, hajt gjuar!
 — Gëzuar e të faleminderit!
 — Mos e thuaj më atë fjalë, se po s'qemë për
 njëri-tjetrin nuk jemi as për vete.
 — Më ke bërë nder të madh.
 — Kështu është kjo: sot unë, nesër ti... epo
 gjuar!..
 — Kur do të përfundojë kjo punë? — e pyes
 për siguri.
 — Mbas një javë eja tek unë dhe do ta shikosh
 vetë. Asnjë orë mungesë s'do të keni më.
 — Faleminderit, të paça gjithmonë... epo gë-
 zuar!

— Gëzuar!

Kaloi java dhe unë përsëri u gjenda përparrë
 depove ku shkarkoheshin automjetet e ndërmarrjes
 sonë... Dhe ç'të shikoja! Krushku e kishte bërë si
 burrat. I qe përveshur vetë punës dhe po shkarkonte
 së bashku me punëtorët. Nuk desha t'u prish roman-
 tikën e punës dhe u nisa drejt zyrës së tij. Thashë ta
 prisja aty gjersa të mbaronte. Hapa derën pa troki-
 tur. Por në krye të tavolinave vendosur në formë
 T-je dikush qe ulur, gjë që më ngatërrroi.

- O, më falni, shoqe, mos gabova zyrë?
 — Kë deshët?
 — Zyrën e shokut Sali!
 — Kjo është, — tha vajza me buzë në gaz, —
 por shoku Sali nuk punon më këtu...
 — Si?! nuk punon më këtu krush... më falni,
 shoku Sali?
 — Jo, kaloi në prodhim.

Mbylla derën dhe u largova pik e helm, sepse n'a
e prishën krushqinë.

— Epo, gëzuar, o krushk dhe punë të mbarë atje
në shkarkim! Tani po të duash vonoi automjetet se
në shpinë i ke.

SI DESH U SĒMURA...

Atë ditë, tek shkoja në punë, teshtita nja dy herë, siç duket nga ajri i ftohtë i mëngjesit. Pas meje po vinte Toli, një shoku im i repartit.

— Shëndet! — më tha ai në vend të mirëmëngjesit.

— Faleminderit! — ia ktheva.

— Ka mbetur zakon i lashtë, kjo shëndet, po s'është shëndet ajo e teshtitura jote, — vijoi shoku im i punës.

— Ç'të jetë, Toli? — e pyeta si me shaka. Dhe këtu bëra një gabim të pafalshëm, se Toli, ngaqë ka pirë në jetën e tij më shumë ilaçe se sa ujë, është bërë një gjysmë doktori, siç i themi ne me shaka.

— Oj, ç'të jetë thua! Ore baba, kot nuk fërshëllen që në mëngjes fyelli i hundës ashtu tre-katër herë.

— Ç'pati hunda? — qesha përsëri.

— Ç'pati ëë! Ja në hundë të janë futur viruset e gripit... Unë, si për të vërtetuar ç'ka thoshte Toli, teshtiva edhe nja dy herë.

— E shikon?... grip e ke... Ja ç'ndodh: (Toli mori pamjen e një këshilltari) viruset e gripit kërkojnë të ngjiten në flegrat e hundës, kurse hunda turfullon t'i nxjerrë jashtë...

Ndërsa Toli vazhdonte të fliste për viruset që ngjiteshin e zbrisnin si ushtarë ogurzjinj, që nuk merrnin dot një kodër, mua m'u duk sikur po më hanin hundët, prandaj nxora xhaminë dhe e férkova.

— Ah! miik vëllai, e paske ngrënë gripin. Kur të ha hunda do të thotë se viruset kanë bërë punën e tyre. Nisu shpejt te mjeku!

Gjithë atë ditë mua më hëngri hunda. Kjo ndodhi ndoshta nga virusi i gripit që më shpjegoi Toli, ose nga virusi që më futi vetë Toli. Sido që të ketë qenë, kjo u bë shkak që unë, duke dëgjuar edhe një shok tjetër, i cili më tha se njeriu ka nevojë për kontroll periodik, vendosa të bëja një vizitë te mjeku, me të cilin nuk kisha pasur asnijëherë punë.

— Nga se vuani? — pyeti mjeku.

— Kam grip.

— Ku e di ti që ke grip? — pyeti mjeku, duke më matur me sy gjysmë të mbyllur, sikur të mirrte shenjë kryevirusin për ta qëlluar.

— Toli më tha! — i fola sinqerisht.


— Nga e mori vesh Toli që ti paske grip? — mjeku s'di pse buzëqeshi.

— I pa viruset që ngjiteshin në hundën time (Gjer në atë ditë unë nuk dija asgjë për viruset). Mjekut i ngriu buzëqeshja në fytyrë:

— Uluni! — Unë u ula.

— Për te cili mjek je nisur? — pyeti mendueshmë.

— Te ju, i thashë — pa marrë vesh, se ai pyeti për specialitetin e mjekut. Dhe unë nuk duhej të kisha asnijë faj, mbasi nuk dija se mjekët ndahen në specialista, si tek ne në oficinë. Shënoi emrin,



emrin e babës, datëlindjen, pastaj e la stilografin
dhe vazhdoi pyetjet me gojë:

- Sa kohë ke që vuani?
- Qysh dje në mëngjes, kur dola nga shtëpia.
- Të dhemb koka?
- Jo.
- Të merren mendtë?

— Vetëm një herë, kur kam pirë raki. Veçse, mbaj mend, atë natë e tepruam disi...

— Nuk të pyes kur je dehur — u nevrikos mjeku.

— Më falni!

— Nga se ka vdekur babai? — pyeti papritur.

— Ka vdekur babai?! Po unë e lashë si kokërr molle... Oh! i ziu..., — e humba unë aty për aty.

— Dale, dale, unë nuk e dija që jeton... po... gjyshi gjallë éshtë?

— Jo. Ka vdekur.

— Nga se ka vdekur?

— Nuk më kujtohet, pasi unë isha fare i vogël, po do të pyes babanë dhe...

— Jeni vizituar ndonjëherë te mjeku?

— Jo.

— Hëm! — ia bëri mjeku dhe, pasi u mendua pak, më tha:

— Merrni këtë letër dhe shkoni tek radiologu.

Pa e bërë të gjatë, mora copën e letrës dhe e mbajta fryshtë te sektori i radiove:

— Urdhëro — i thashë përgjegjësit. Ai e mori, e lexoi një herë, mblodhi supet, e lexoi edhe një herë, pastaj më pyeti:

— Kush ta dha këtë letër?

— Mjeku!

Përgjegjësi qeshi:

— Ke bërë ndonjëherë radioskopi?

— Jo.

— Po mjeku, me qira e kish gojën që të të thoshte se radioskopia ishte po në atë ndërtësë, dy dyer më tej?

Prej aty shkova te radiologu, të cilin as e pashë dhe as më pa, mbasi çdo veprim u bë shpejt e shpejt,

në të errët, duke përfshirë këtu edhe shënimin që bëri ai në pusullë.

— Ç'kam, doktor? — mora guximin dhe e pyeta.

— Asgjë për t'u shqetësuar! — tha shkurt. «Mesa duket do të kem diçka me zarar, përderisa nuk më tregoi gjë» mendova unë dhe dola.

Duke mos ditur se ç'do të kisha, gjersa s'më tregoi as radiologu, të them të drejtën, më zunë të prerat. Më dukej se mushkëritë më kishin shkuar në fund të barkut. Ndonjëherë më bëhej sikur më çaheshin brinjët dhe dilnin lobet e mushkërive përjashta si gjuhë lope. Atëherë u ndjeva me të vërtetë i sëmurë. Koka më dhimbte, fytì m'u tha, këmbët nuk po më mbanin më. Mezi arrita të futem te mjeku i parë, i cili më mori fletën nga dora dhe, si e pa me kujdes, e vuri mbi tavolinë. Pastaj më vuri termometrin nën sqetull. Priti pak, e hoqi dhe e pa më vëmendje:

— Keni temperaturë, zhvishuni! — Ai mori fëndonoskopin dhe e vuri në vesh:

— Merrni frymë, ashtu... kollituni... ashtu... merrni frymë thellë... ashtu... kthehuni në kurri... ashtu... Merrni frymë, kollituni... ashtu: Më vizitoi kështu mirë e mirë, pastaj më tha:

— Çohuni, keni stomak?

— Kam! — i thashë pa të keq.

— Si?! E dini që keni stomak dhe nuk më thatë gjë? — u nxeh ai.

— Më falni, doktor, mos u nxehni. Mua kurrë nuk më ka shkuar mendja që një mjek të mos dijë se të gjithë njerëzit kanë stomak.

Ai e kuptoi shakanë, buzëqeshi dhe më bëri shenjë të vishesha.

— Më falni, në qoftë se thashë ndonjë gjë jo të saktë nga ana profesionale.

— Ore shok dhe ju të më falni në qoftë se nuk u vjen mirë, por ju jeni i sëmurë nga stomaku. Më kuptuat besoj...

— Oh! Unë i ziu dhe sëmundja e stomakut më duhej! Sa isha te radiologu më dhimbnnin mushkëritë, që duhet të më kenë shkuar në fund të barkut... Po ç'pati stomaku i uruar që m'u sëmur sot? Unë kam pesëmbëdhjetë vjet që i hedh edhe në darkë nga një kupë me fasule e mish derri, dhe ai, përveç detyrës, asnjë proçkull tjetër nuk më ka bërë...

Unë pushova, ndërsa mjeku ra në mendime. Unë rri, ai rri. Me një fjalë rri të rrimë. Mbas pak më bëri një pyetje, që kurrë nuk e prisja:

— A keni pasur ndonjë të çmendur në familje apo në fis?

— Të çmendur?!! Unë rashë në mendime: Ç'lidhje, vallë, kishte një stomak i sëmurë me një të çmendur? Me sa ma preu mua mendova: Meqenëse stomaku dhe koka bluajnë të dy: njeri mendimë tjetri ç'ti hedhësh, duhet të ketë lidhje midis një të çmenduri dhe të një të sëmuri nga stomaku...

— È? Nuk të kujtohet.

— Jo, më duket nuk kemi pasur.

Kushdo e merr me mend gjendjen time, gjendjen e njeriut edhe të sëmurë edhe të shëndoshë edhe që s'di nga se vuan. Tani sytë i mbaja vetëm te mjekët, sepse, siç dihet, në qoftë se sëmuresh nga mushkëritë, nuk ke me se të marrësh frymë, pa lere stomaku që të lë pa ngrënë!

U ktheva në shtëpi. Gruaja, sa më pa, klithi:

— Konstandin, o i zi, ç'qenke verdhur si lule kungulli?

— Jam pak pa qejf — i thashë, ndërsa vrisja mendjen se përveç sëmundjeve që thanë mjekët, mund të kisha edhe nja tre-katër të tjera po aq të rrezikshme.

— Shko e vizitohu te mjeku! — u alarmua ajo. Kishte të drejtë, se nuk e dinte që unë kisha 5-6 orë që merresha me mjekët. Aq sa tani doja të shtrihesh, gjë që e bëra pa vonuar.

Lajmi u përhap menjëherë më ndërmarrje dhe shokët pa vonuar u mblozhën rrëth meje. Midis tyre ishte edhe Toli, i cili, sa hyri në dhomë, më qortoi.

— Ah kokëfortë, kokëfortë! Nuk më dëgjove mua, që t'i dilje së keqes përpara qysh në mëngjes! Hë tani, vuaj e lëngo nja dy vjet në shtrat!..

Ndërsa Toli vazhdonte leksionin e tij për mje-kesinë, mua më kishte zënë gjumi. Kur u zgjova, mbi kokë qëndronte babai:

— C'pate, azgan i babait? Një herë vajte te mjeku dhe u sëmure nga frika. Çohu, ore, se në qafë time po pate gjë ti!

Unë, jo vetëm që nuk u ngjifta, por u ktheva në krahun tjetër. Ende s'isha ngopur me gjumë.

Të nesërmen vajta prapë te mjeku, po aty gjeta një tjetër.

— Urdhëroni! — Ai më dha dorën, ma shkundi me përzemërsi, pastaj më tregoi karrigen. U ula. Pasi më vizitoi qetë-qetë, urdhëroi:

— Duart përpara, hapi gishtërinjtë!

Me sa dukej aty kishin orarin e gjimnastikës. I zgjata duart para dhe i thashë mjekut:

— Edhe ne në uzinë e bëjmë gjimnastikën rregullisht. Vetëm ata të administratës sikur... .

— Të lodh gjimnastika — qeshi doktori. — Mua,

s'di sepse, po më vinte rrotull dhoma me ç'kish bren-
da. Prisja të zalisesa nga çasti në çast.

— Tani tregomëni hollësish se si të ndodhi! —
pyeti mjeku. Dhe unë i tregova gjithçka një për një.
Ai buzëqeshi, më rrahu shpatullat dhe më tha:

— Sugjestion, dhe asgjë tjetër. Je ndër më të
shëndetshmit që kam njojur deri më sot.

— Kështu më duket edhe mua.

— As topi nuk e luan.

U ndamë si miq të vjetër, por pa ndonjë dë-
shirë ta takoja sërisht në ato rrethana.



PRITJA E KRUSHKUT...

Lokali ushqimor atë ditë në mëngjes nuk kish shumë punë. Kishin zënë radhën vetëm dy burra dhe tri gra. I pari nga burrat qe një i moshuar (duket në pension), që nxitohej.

— Shoqe, luajini pak duart, se na zuri dreka këtu.

— Pse nxitoheni kaq shumë sot, xha Ali — e pyeti shitësja me mirësjellje.

— Si të mos nxitohesh kur pret krushkun!

— Të trashëgohen! — i uroi një grua. — E ke fejuar larg çupën?

— Larg vërtet, po sot vete e vjen brenda ditës, se u bë pëllëmbë e xhade.

— Si e quajnë? — pyeti ai që priste pas tij.

— Hazbi ia thonë emrin, po unë as që e kam parë ndonjëherë. Më vjen sot për herë të parë në shtëpi. Ndaj dua ta nderoj ashtu siç e meriton.

— T'u trashëgohen! — uruan të tjerët në kor.

— Faleminderit dhe në gëzime në dyert tuaja!

Në këto çaste në lokal u fut me nxitim një burrë rrëth të gjashtëdhjetave.

— Shoqe, ju lutem dy pakos llokume.

— Llokumet nuk merren llokume. Mbaj radhën, njëherë, pa shohim e bëjmë! — ia priti xha Aliu.



— Kam hall, more vëlla! — hapi duart i porsa-
ardhuri, sikur të peshonte hallin me duar.

— Edhe ne për hall kemi ardhur këtu. Tezet
nuk i kujtojnë fare — bëri humor, plaku që kishte
radhën.

— Je plak me thinja e s'të kanë lezet ato fjalë
prej kalamani! — u nxeh tjetri.

— Kujt i thua kalama? — u nxeh më fort xha Aliu.

— Ty, more, të them, — iu përgjigj i porsaardhuri.

— Xha Ali, merre më gjak të ftohtë! — foli shitësja.

— Dëgjo ti, nusja e xhaxhait! Unë nuk e kam fjalën te radha, po te respekti që duhet të kemi për njerëzit, te edukata, a më kupton?

— Pa pyetëm njëherë, pse nxitohem, pastaj gjykomë! — tha me të qetë i porsaardhuri.

— As që dua ta di nga je — ia ktheu kokën xha Aliu.

— Epo më fal, or mik, po zotrote qenke nevrik.

— Mbaj gojën ti, se unë nuk jam nevrik por hundëlesh.

— Qofsh me shëndet, po nuk ma merr mendja të jesh nga ato klloçka ti. Kanë qenë burra të tjerë ata, po zotrote s'i ke arritur! — tha i porsaardhuri.

— Kush, more, s'i paska arritur? — Dhe xha Aliu bëri pérpara. Ana e djathtë e mustaqeve i dri-dhej si në ethe:

— Me mua gjete të tallesh ti? Po a e di se unë të tregoj sinorët?

I porsaardhuri gjithashtu bëri pérpara, por tash-më jo për të marrë llokumet.

— Sinorët nuk ka burrë të m'i tregojë mua!

Xha Aliu, ca më i krekosur, ia ktheu, të panjohurit:

— A ka shumë burra si ti andej nga anët tuaja? Tjetri ngriti bastunin, po jo për të qëlluar.

— Po deshe del njëherë t'i shikosh!

Të tjerët prishën radhën dhe u futën në mes.

— Turp, ore, c'kini që zahi, merrni ç'të doni dhe sa të doni, kush ua mban?

— E dëgjove, or mik, më zure ngushtë sot që kam fejesën e çupës, po dija unë si flisja me ty.

— Edhe unë dy pako llokume kërkova, për fejesën e djalit...

— Pse zahi, more shok, dy veta jeni në radhë, dymbëdhjetë do të kishim blerë gjer tan! — tha shitësja.

— Jo, po këtu çështja qëndron tek edukata e burrit! — sqaroi xha Aliu.

— Ama burrë më qenke, pale po paske fejuar dhe djalin. Po kush paska qenë ai pykë që ka bërë krushqi me ty?

— Pykë është ai që të mori çupën ty. Të bukur krushk që ka bërë! Një burrë si ti andej nga ne nuk e pranojnë as në fshat.

— Mbylle gojën, për nder, se më duket e te-prove!...

Shitësja e kish mbërthyer nga xhaketa xha Ali-në dhe i lutej:

— Xha Ali, mos e prish gjakun kot, të paktën sot që ke fejesën e çupës. Ju kot fare u ngatërruat. Ja, shok, merri llokumet dhe me trashëgime.

— Mirë thua, moj çupë e babait, me cilin të merrresh?

— Doemos duhej të gjeje ndonjë shokun tënd.

— Për nder, po të mos kisha këtë fejesë, sot, të mos më thërrisin më Ali Sinani pa e bërë njérën.

— Ali Sinani! — përsëriti plot habi ai tjetri, që mbeti me llokume në duar. Ndërsa shitësja bënte çmos që ta përcillte sa më parë.

— E ore, dora vetë, pse çudite kështu? — u kre-kos xha Aliu dhe i hodhi një shikim përqmues.

— Më fal, or mik, po më duket desh e katranosëm. U vramë pa njohur, siç i thonë.

— Si? Pse, çfarë, kush je ti?!

— Po unë jam krushku i Ali Sinanit, Tefik Veliu, a derëbardhë!

Në lokal shpërthyen të qeshurat.

— Ama, si burrat e bëtë!

— Çudi qysh e mbajti gjithë këtë ujë pilafi!

— Shyqyr që u mbyll me kaq, se do të na ishte prishur edhe krushqia.

— Mos na e qani hallin ju, — ua ktheu romuzeve me romuz xha Aliu. — Se sherri për burrat është.

Pas kësaj njohjeje të ngrohtë, të dy krushqit morën njëri-tjetrin dhe bënë tutje drejt atyre që prisnin në shtëpinë e xha Aliut.

PËRSE KËRCET KARRIKJA?...

Këtu nuk e kemi fjalën për një karrige dosido, që mund të kërcasë, të rënkojë ose të thyhet dhe ne t'i qëndrojmë sipër sa të duam, pa e prishur qej-fin fare. Jo. Këtu nuk bëhet fjalë për një karrige klubi, që e vëmë poshtë pesë orë, duke i shërbyer barkut me ndonjë gotë. Jo. Këtu nuk bëhet fjalë as për një karrige të shtëpisë, që po të kërcasë ia mbyllim gojën aty për aty me disa gozhdë ose tutkall. Joo! Këtu, more vëlla, bëhet fjalë për karrigen e një shefi që kërcet. Të kuptohemi: kërcet karrigia, jo shefi! Atëherë, përse kërcet një karrige shefi? Ja, këtë pyetje bëri edhe shef Selimi, kur u ul atë mëngjes, si zakonisht, në karrigen e tij, e cila e mbante për pesëmbëdhjetë vjet rresht. Megjithëse shoku Selim e kalonte peshën e kuintalit, ajo prapë nuk qe ndier. E mbante atë rehat-rehat, pa kërcitur e pa u ankuar. Dhe shef Selimi lëshonte nga ajo karrige urdhra e udhëzime njërin pas tjetrit. Ngarkonte e shkarkonte cilindo nga raftet ose sirtaret, pa pasur asnjë ankesë nga... karrigia. Mirëpo atë mëngjes, plot në orën shtatë, kur ai, si gjithëherë, u ul mbi të, ajo kërciti gjatë. Kjo e habiti fort shefin, prandaj u çua dhe lëvizi karrigen nga vendi. Ajo s'u ndie këtë herë. Dhe ai u ul. Këtu karrigia filloj përsëri të kërcasë.

Kjo gjë e bëri të hidhet përpjetë dhe t'i bjerë ziles.

— Urdhëro, shoku shef! — Punëtorja e pastrimit kishte ardhur menjëherë.

— Më thirr një marangoz, se më kërcet karri-gia! — Punëtorja e pastrimit u largua, për të zbatuar urdhrin, ndërsa Selimi vetë qëndroi më këmbë pranë dritäres në pritje të marangozit. Dhe ai nuk u vonua. Këtë e tregoi menjëherë e trokitura në derë.

— Hyrë! — urdhëroi shefi. Në zyrë hyri marangozi me gjithë çantën e madhe të veglave të punës.

— Mirëmëngjes, shoku shef!

— Mirëmëngjes, si u gdhive? — Pa shikoje një herë këtë karrige, more shok, se më duket ka filluar të kërcasë. Dhe për ta provuar, shefi u ul në të. Karrigia nisi të kërcasë, si një rrotë qerreje e pa grasa-tuar... E dëgjon?! Po a mund të punohet me ulërimat e kësaj karrigeje?

— Natyrisht, për një punë si tuajën duhet shumë qetësi.

— Ashtu është, ashtu është, vetëm s'di çfarë ka?

— I janë liruar vidat, c'të ketë tjetër? — tha marangozi me kompetencë. Ai aty për aty mori një kaçavidë dhe i shtrëngoi të gjitha vidat shpejt e shpejt, pastaj u ul vetë në karrigen e shefit (gjë që s'i pëlqeu aspak atij), e tundi dhe e shkundi disa herë, po karrigia nuk u ndie më.

— Të rrini gjëzuar! — tha marangozi dhe mori veglat e u nis.

Selimi, i bindur se karrigia nuk do ta bënte më atë marifet, u ul. Por, për çudi, karrigia filloi përsëri të kërcasë. Kjo gjë e la pa mend atë. U ngrit e u ul përsëri disa herë. Dhe çdo herë karrigia kér-ciste e rënkonte me të madhe.

— Ma thirr edhe një herë atë djall marangozi

— e urdhëroi përsëri shefi punëtoren e pastrimit. Marangozi u gjend menjëherë për të dytën herë në zyrën e shefit.

— C'djall riparimi bëre? — thirri Selimi i nervozuar dhe u ul në karrige, e shkundi dhe e tundi disa herë nën ulërimat që nxirrte ajo.

— Unë sikur...

— C'sikur, more, merr edhe paranë për kategori të shtatë!

Marangozi nuk u ndie më, po mori kaçavidën dhe i shtrëngoi vidat kaq fort, sa po i dhimbnin duart. Së fundi, kur u bind se karrigia qe rregulluar shumë mirë, u ul vetë disa herë, duke e shkundur përsëri me gjithë forcën e trupit të tij. Karrigia s'u ndie më.

— Shoku shef, a ka mundësi që ta provoni edhe një herë vetë?

Selimi u ul, por karrigia filloi avazin. Marangozi çakarriti sytë, sikur të kish parë një akrep në qafë të shefit.


— Të bukur punë — tha me ironi Selimi: — Si ka mundësi??!

— Duhet të jetë çështje peshe, shoku Selim! — konstatoi marangozi. — Fundi, kjo karrige e vjetër është. Si t'ia bëjmë?

— Zor i madh! Një karrige tjetër nga depoja — urdhëroi shefi. Kështu Selimit i prunë një karrige të re nga magazina. Ai e mori me kënaqësi dhe e vuri në vend të së parës.

U ul qetësisht në të, por edhe karrigia e re kërciste, ndonëse jo si e para.

— C'ia paskan shkelur gazit në dërrasë ata të kombinatit të drurit! — u ankua shef Selimi.



— U pa puna, duhet tē zgjedhim një karrige tjetër! — tha marangozi.

— E pse jo! — e mbështeti shefi.

Kaloi një copë herë e mirë kështu, duke ndërruar karriget që kërcisnin. Aq sa shefi e humbi toruan. Filloi t'i flakë karriget me nervozizëm si bostonë tē çarë... Kishte kohë që nuk ishte nxehur kaq shumë shefi.

— Djalli e mori... Ata tē kombinatit tē drurit

dashkan një dru të staxhionuar që... Të ishte përmua i pushoja në vend të gjithë... Po edhe këtu duhen pushuar në vend disa... Fjala vjen, të pushohet magazinieri, se nuk është kujdesur sa duhet përkollaudimin e mallit. Edhe punëtorët e magazinës duhen pushuar... edhe kolauditori... edhe merceologu... edhe...

Në gjithë këtë zhurmë nervoze u dha në derë grupei i kontrollit punëtor.

— C'janë këtu gjithë këto bubullima? — pyeti me buzë në gaz njëri prej tyre. Marangozi shpjetgoi se si qëndronte çështja... Pra, problemi ishte tepër serioz.

— C'mendoni, shok, për këtë problem? — pyeti një tjetër, dhe, pa marrë përgjigje, vazhdoi: — unë mendoj të organizojmë një sesion shkencor me temën: «Përse kërcet karrigia e shefit».

— Në fakt duhet dhënë tema: «Përse kërcet shefi ynë» — tha një punëtor tjetër.

Shefi sikur e ndieu thumbin e ironisë së punëtorit, prandaj veshi petkun e tij të zakonshëm:

— Ti shok, në qoftë se ke ardhur për thumba, më mirë dil jashtë. Ne na zien koka përkëtë çështje, që kërkon njerëz kompetentë për ta zgjidhur, kurseti na tregon përralla.

— Besoj se më kompetentë se ne punëtorët nuk do të ketë njeri...

— Urdhëroni e zgjidheni — buzëqeshi shefi, duke i kuptuar shqeto fjälët e punëtorit.

— Mendoj se një grup pune i vogël nuk do të konkludojë dhe aq drejt — tha Saliu.

— Po si i bëhet? — pyeti shefi.

— Ta shtrojmë çështjen në kolektivin e ndërmarrjes. T'i pyesim punëtorët.

— Jo, jo, unë jam i mendimit të mos i shqetësojmë punëtorët për një gjë kaq të vogël. Më mirë po ndërroj prapë karrigen... tha shefi, duke ndier «rezikun».

— Ndoshta punëtorët mendojnë se duhet ndërruar shefi dhe jo karrigia...

Selimi i zgurdulloi sytë:

— Me gjithë mend e keni? — pyeti.

— Ne punëtorët çdo gjë e kemi bërë dhe e bëjmë me mend, apo jo?

— Po, xhanëm po, po sikur të ndërroja karrige, s'do të merrte kaq të tatëpjetë puna!

VARIANTI «SALLATË»

Kur më kërkoi inspektori i fiskulturës dhe i sporteve, donte edhe një muaj të fillonte kampionati kombëtar i futbollit. Thirrja qe urgjente, prandaj nxitova këmbët dhe u paraqita para këtij inspektori, i cili më kishte vënë në një hall të madh:

— Erdhët?!... Ju lumshin këmbët! Ja ç'do të thotë të kesh qenë futbollist! Ju do të bëni pjesë në ekipin e futbollit të qytetit tonë.

— Unë? — u çudita. — Po unë kam dhjetë vjet gjë e kam lënë futbollin!

— Vërtet e keni lënë, po mos harroni se keni luajtur njëzet e pesë vjet dhe përvoja juaj kaq e gjatë do të jetë një mbështetje e fortë për ekipin tonë.

— Unë mund t'ju qëndroj pranë si punë këshilltari, por që të loz vetë sikur nuk më punojnë gjunjët — arsyetova.

— Gjunjët vijnë duke ngrënë, apo e harrove fjalën e urtë të popullit: «Jepi në gojë që të bëhet soj».

— Edhe kështu s'më ka munguar ushqimi...

— Këtu është fjala për një dietë suplementare, speciale, shkencore — ma preu fjalën ai.

— Unë ushqimin përherë të tillë e kam pasur.

— Si, nuk pranon? — u nxeh ai. — Në fund të fundit ka edhe urdhra, dhe mbaroi. Ne thamë se do të na kuptoje. Pse, ku jemi këtu? Vërtet aktivitet është, po është me përgjegjësi, ama! I thonë kampionat kombëtar këtij, e nuk i thonë as domino, as billardo. Të tjerët bëhen copë për një biletë, kurse ti refuzon të hysh në stadium si në shtëpinë tënde. Pra u vendos. Qysh nesër fillon stërvitja. Do të grumbulloheni menjëherë për këtë muaj që na ka mbetur...

Në këtë kohë u hap dera dhe u fut brenda një plak rrëth të shtatëdhjetave, me bastun në dorë. Rruga për këtu e kishte lodhur, pasi nuk po mbushej dot me frymë.

— O, mirë se erdhe, shoku Muhamet! Inspektori ma paraqiti.

— Shoku Muhamet do të emërohet trainer i ekipit të futbollit të qytetit tonë.

Unë nuk u zura besë veshëve, ndërsa plaku zgjati qafën e rrudhur:

— Çfarë, çfarë më emërove?

— Trainer të ekipoit të futbollit.

— Ç'është ky traineri?

— Ja, të mësosh çunat si të luajnë me top.

— Unë?! — u tremb plaku. — Po mua mezi më mbajnjë këmbët për vete.

— Sikur do luash vetë! — i tha inspektori.

— Çudi e madhe! — tha plaku. — Ore jeni në vete ju apo...

— Shoku Muhamet, ju duhet t'i bindeni vendimit tonë kolegjal.

— Ky nuk është vendim i tillë. Këto janë prroçka dhe jo vendime.

— E keni gabim! — u nxeh inspektori. — Kësh-tu pra: nesër të njëzet lojtarët, së bashku me trainerin, të dalin në fushë! Ju, shoku Muhamet, duhet të mos kurseni eksperiencën tuaj për çunat, aq më tepër se keni edhe përvojë ndërkombëtare, se, vetë më keni treguar, më duket, që keni parë një ndeshje në Stamboll më 1923 apo jo? Inspektori i rrahu krahët trainerit të ardhshém me përvojë ndërkombëtare, duke myllur me këtë gjest edhe takimin tonë. Por plaku kundërshtoi dhe doli pa i marrë leje bashkë-bisuedesit.

Të nesërmen, në orën tetë, të gjithë ne të ekipit u rreshtuam në fushë, në pritje të trainerit tonë. Por minutat kalonin dhe ai s'po dukej gjékundi. «Epo, plak njeri — mendova unë. — Do ta ketë shtrënguar reumatizma ose asma dhe mund të vonohet edhe ca».

Por ai po vonohej ca si shumë. Ne vendosëm t'i dërgonim fjalë se e prisnim. Dhe i dërguam. Po ai na e ktheu shpejt përgjigjen.

«Filloni, djemtë e xhaxhait, fillojeni vetë atë punë».

— Çfar do të bëjmë tani? — pyeta unë.

— Çfar do të bëjmë? — më pasoi një shok. — Po për çfarë jemi mbledhur këtu, more shok? Ja mo, të luajmë me top. C'ta zgjasim? Hajdeni të fillojmë vetë, se do të ftohem. Dhe ne filluam të lozним ashtu si na vinte pér mbarë.

Vazhduam tri ditë kështu. Por kjo nuk mund të vazhdonte gjatë. Nuk luhej pa trainer. Siç ishim kollektiv, vajtëm dhe iu ankuam inspektorit. Ja raportuam gjendjen dhe ai mori masa në vend: thirri punëtorin e fushës dhe e emëroi trainer të futbollit.

— Trainer unë, shoku kryetar?? Po unë nuk...

— Lëri fjalët, po zbato urdhrin, se ne këto urdhra nuk i lëshojmë në tym, po kemi një farë baze.

— S'keni asnë bazë! — kundërshtoi përsëri punëtori i fushës.

— Si the?! Po njëzet vjet që punoni punëtor fushe... pak ndeshje keni parë ju?

Dhanë e morën, po s'e gjetën që s'e gjetën dot fjalën me njëri-tjetrin. Inspektori në të tijën, punëtori i fushës në të tijën e ne, si ekip, më vete: pa trainer. Vijuam ashtu, autodidakçe stërvitjen.

Kështu kaloi java e parë. Në javën e dytë erdhi një trainer i ri, që kishte qenë këshilltar i një traineri tjetër të qytetit fqinjë. Në fillim na kërkoi t'i njoftonim se ç'kishim bërë në javën e parë të stërvitjes dhe, si mori përgjigjen tonë, u alarmua:

— Qysh!!! Nuk e keni filluar me preqatitjen fizike juve!!! Po kjo është alarmonjëse! Po kjo është shkatërronjëse, katastrofale, bile... shpejt në rresht! — urdhëroi. Ne u vumë në rresht, duke pritur kështu urdhrat e trainerit tonë. U bëmë me trainer më në fund...

— I shikoni ata gurë atje? — bëri me dorë nga një grumbull gurësh që kishin tepruar aty nga ndërtimi i stadiumit.

— I shikojmë! — thamë ne duke mbledhur supet.


— Mirë! Tani secili nga ju të zgjedhë nga një gur të madh, ta ngarkojë në kurriz a në krahëror dhe në drejtim të asaj majës së kodrës atje!

— Çfarë do të ndërtohet atje? — pyeta unë.

— C'ndërtim, more?! Kalitje, kalitje, se jeni bërrë si derrkucat e fermës.

Ne mbetëm të topitur. Traineri na shkundi.

— C'më rrini kështu? Shpejt, zbatoni urdhrin!



U desh plot dy javë që ne të kaliteshim fizikisht me këto metoda spartane.

Kur erdhi traineri tjetër, që sa kishte mbaruar shkollën e mesme të përgjithshme dhe që dalluar në orët e gjimnastikës, kishte mbetur vetëm një javë nga fillimi i kampionatit.

— Turp, o turp! C'stërvitje keni bërë që nuk u

ka mbetur mish në trup, po vetëm kockë dhe lëku-rë? Turp, turp... Pastaj ai u qetësua!

— Mirë, djema, rreshtohuni!

U rreshtuam. Traineri filloi.

— Sot, djema, dhe në ditët e ardhshme të stërvitjes, do t'i japim më shumë prioritet elementit teknik dhe atij tematik. Të jesh lojtar teknik do të thotë që ta dredhësh kundërshtarin në tel si në cirk, do të thotë që topin ta përdorësh me të gjitha pjesët e trupit, me përjashtim të duarve. Gjihash tu të jesh lojtar teknik do të thotë që të luash futboll modern siç luan, bie fjala, Paraguai... Ju besoj se i kini parë ndeshjet ndërkontebtare të tyre. Pra qëllimi ynë është që të bëhem si ata dhe t'i kalojmë, bile.

— Brenda një javë nuk e besoj t'i arrijmë — thumboi portieri, që qe i vetmi për batuta të tilla.

— Vullneti, shok, vullneti! Çfarë s'bën vullneti! Edhe ju po të keni... Në këtë kohë mua s'më mbajtën më gjunjët, u këputa e rashë pa ndjenja. Shokët me dacka dhe punëtori i fushës me një kovë ujë më prunë në vete.

— Ah! Ah! — thërriste tërë dëshpërim traineri — ja ç'i bën stërmundimi lojtarit! Uluni, shokë, se u këputët. Të gjithë u ulën në mes të fushës, në barin e njomë. Traineri vazhdoi:

— Pra, tani të hidhemi në elementin taktik. Variante taktkike bota njeh shumë. Unë do të mundo hem që t'i zbirthej një nga një. Marrim sistemin $4 + 2 + 6$.

— Po kështu bëhem dy mbëdhjetë, profesor, mos do të lozni edhe ju? — pyeti portieri. Pa e humbur fare, traineri u përgjigj:

— E korrigjojmë! $5 + 2 + 4$. Në këtë variant portieri duhet të hapë sytë, sepse... Mua po më mby-

lleshin sytë. Nëpër gjumë dëgjoja fjalë e fjali të shkë-putura si: mezi i fushës... të mos ngatërrrohet me portierin... mbrojtja... gjumë... Menjëherë mblo-dha veten, sa dëgjova fjalën gjumë, po, kur hodha sytë, pashë se edhe disa shokë të mi ia kishin marrë me gërrhima, ndërsa traineri vazhdonte.

— Brazili kundër Anglisë aplikoi këtë variant dhe e kurorëzoi fitoren e tij vetëm me një sulm të rrufeshëm në minutën e 89-të, kur një bombë...

Më tej nuk dëgjova gjë, sepse bomba nuk plasi dhe mua më mori gjumi...

Në ndeshje ne nuk aplikuam dot asnjë nga variantet taktkike që na rekomandoi traineri, pasi ca luanin me variantin e tyre personal, top për top, ca të tjerë me variantin e inspektorit e ca më «të dalë ku të dalë». Pati edhe nga ata që e çonin topin kod-rave, atje ku kishim çuar gurët.

Kështu na doli varianti i ri «varianti sallatë», të cilin po e shikojmë edhe në disa ndeshje të tjera të aplikohet me «sukses».

KU MË KE, MOJ XHAN...

Më në fund m'u mbush edhe mua mendja se po fejohem. Për të fejuar jo xhanëm, po jam shumë i sigurt se ajo më do. Pra, e kam kuptuar që ajo më do, por unë ende nuk i kam thënë «të dua». Guximi s'më mungon, se, të më njihni mirë, unë jam shofer që i kam rënë kryq e tërthor Shqipërisë, në dëborë e në alkull, në rrugë e pa rrugë. Veç kur erdhi një rast që t'ia thosha më ishte njomur kandella. Pra nuk ia thashë dot. Dhe u ndamë dy herë më të përmalluar. Një herë vendosa që t'i shkruaj një letër e t'ia thoshja shqeto, po veç për të shkruar letra duhet të dish. Dhe unë në këtë gjini mbetem në klasë kur të duash, prandaj ndryshova mendim. Po sikur t'ia thosha në telefon? Se ka pasur edhe raste të tilla. Nuk e zgjata, i bëra lajmthirrje.

Në orën e caktuar u ndodha në postë. Po mundohesha të qetësoja zemrën, që kishte marrë «superxhiro», ashtu siç merr ndonjëherë motori i makinës sime. Mirë motorin që e qetësoja menjëherë, po dalldinë e zemrës si mund ta mbaja?

Prita deri sa të dyja centralistët e të dy qyteve i gjetën telat dhe na lejuan ne të dy të fillonim bisedimin.

— Lamçja me Vlorën, kabina Nr. 3! Hyra në

kabinë dhe mora receptorin. Zemra i kaloi 120 km, më falni, të rrahura në minutë. Megjithëse qe janar, djersët më shkonin rrëke.

— Alo, alo! — zëri i saj më dukej sikur vinte mjaltë e sheqer dhe mua të shkretit sa nuk më shkrijët një bjellat.

— Alo, alo! — fola edhe unë ashtu kot, duke u çuditur me zërin tim, që nuk e njoha fare.

— Alo, ti je Lamçe? — pyeti ajo.

— Unë jam, unë...

— Ku je, more?

— Ja këtu, në kabinën Nr. 3!

— Si je? — pyeti ajo.

— Në këmbë, si djalë, nuk kanë vënë një karri-ge. — Ajo qeshi me të madhe. Dhe unë qesha, mençenëse qeshi ajo. Pastaj heshtje. Unë shtrëngoj fort receptorin në vesh. Ajo vazhdoi:

— Lamçe!

— Urdhëro! — Ajo përsëri heshti! Unë po prisja në ankth.

— Lamçe! — më foli përsëri Flutura.

— Urdhëro! — ia ktheva prapë unë.

— Më ke...

— Të kam. — u përgjigja pa e lënë të vazhdonte dhe duke u bërë flakë i kuq.

— Ku më ke? — erdhi zëri i saj kurajoz që nga Vlora.

— Ja këtu. Unë vura dorën në zemër, e cila tani i kaloi të 150 goditjet.

— Ku? — nguli këmbë ajo.

— Ja këtu! — dhe i rashë zemrës fort me dorë.

— Ku? Aty, në kabinë?

— Jo, jo, ja këtu... në zemër, doja t'i thosha, po m'u tha gjuha e s'ia thashë dot. Ajo qeshi, dhe unë

qesha. Oh! Ç'lumturi! Tani me të vërtetë më shkrinë bjellat, së bashku me bronxinat. Më mbeti mua rada, që ta pyesja se ku më kishte. Mobilizova të gjithë kurajon time civile dhe i fola:

— Alo, Flutura!

— Urdhëro.

— Po ti, më ke?

— Të kam. — Ajo psherëtiu dhe mua m'u duk se nga linja e Vlorës erdhi tensioni 6000 volt.

— Po ku më ke? — e pyeta duke u dridhur.

— ... —

— Ku më ke — pyeta prapë. Heshtje. Heshtje torturonjëse. Zemra punonte me 200 goditje. Ja më në fund një zë femre:

— Shok, u pre linja! — ishte centralistja.

— Çfarë?! — më fluturoi kapelja nga koka.

— Shqip të thashë, u pre linja, duket ka ndonjë difekt. Mos është rrëzuar ndonjë shtyllë.

— Shoqe! Të lutem shumë lidhmë prapë!

— Shok, ju lajmëruam se kemi difekt në linjë!

— Po ajo nuk ma tha, moj shoqe.

Dola nga kabina pik e vrer. Isha gati të merrja tamburin e të shtrija linjën gjer në Vlorë.


— Sa kohë do që të rregullohet linja? — e pyeta centralisten me një shkëndijëzë shprese.

— Nuk dimë se çfarë difekti ka, por ti prit njëherë.

— Të faleminderit, po nuk më thua ajo a do të më presë? — Centralistja ngriti supet. Megjithatë unë prita dy orë që m'u dukën dy shekuj. Më në fund dola nga posta dhe po ecja s'di se ku, kur takoj një shokun tim, shofer Refatin.

— E, mo Lamçe, tapitë e shtëpisë të kanë humbur? — U përshëndetëm, pastaj Refati më pyeti:

- È more vesh se ç'i ndodhi Qenanit?
— Jo.
— I ra shtyllës me kokë.
— Ku?
— Në rrugën e Vlorës!
— Mos, more, po përse ma bëri këtë? — thashë
në kulm të dëshpërimit.



- Ishte në shpejtësi! — sqaroi Refati.
- Prandaj nuk ma tha ajo — fola padashur.
- Çfarë? — pyeti Refati.
- Asgjë, asgjë, — mblodha veten, — mirë u pafshim!

Vendosa të nisesha në Vlorë, megjithëse një natë më parë kisha udhëtuar nga Tropoja për gjithë natën. Për fat (apo për taksirat) takova një shokun tim. Hipat.

— Shpejt, Qamil, se e kam urgjent punën. Dhe Qamili i vuri të pestin, gazin në fund. Makina hante 90 në orë. Si kaluam me sukses Fierin, hymë në rrugën e Vlorës.

Plepat në të dy anët fluturonin prapa, ndërsa ne përpara me tërë shpejtësinë. Qamili ia mori këngës, kurse unë ia mora me gjumë. Duket nga lodhja dhe ngaqë kisha 32 orë pa fjetur. Në ëndërr më doli Flutura dhe më buzëqeshte, duke më zgjatur duart. Sa hapa krahët që ta përqafoja, kur ndjeva një tronditje të menjëhershme, të shoqëruar me një zhurmë shurdhonjëse metalike. Flutura më humbi nga sytë, ndërsa unë rashë përsëri në kllapi. Përsëri u zgjova. Para meje qëndronte, s'di se kush.

— Ku më ke? — e pyeta.

— Ja këtu, në hendek, me makinën me rrota përpjetë! — m'u përgjigj. Unë rashë përsëri në kllapi.

S'di pas sa kohësh u zgjova përsëri dhe para meje, ashtu si në mjegull, më doli Flutura e veshur krejt në të bardha. Unë zgjata krahët nga ajo:

— Ku më ke, moj xhan? — e pyeta i gëzuar.

— Ja këtu në shtrat, të shtruar në spital. — Ishte infermierja e pavionit. Në të djathën time Qamili ia kishte marrë me gjumë.

«USTALLARËT» E KULTURËS...

Quhem saksofon, ose më shkurt saks. Dhe jam shumë i fyer që më thérresin tyrylyçkë. Nuk kuptoj pse ma kanë ngjitur? Ku e dëgjova? S'e dini? Në dasmë, ore, në dasmë. Dhe jo në një, por në disa dasma. Kam bredhur, ose më saktë, më ka bredhur imzot, që është instrumentist në shtëpinë e kulturës. Ky imzot, që thoni ju, është qejfli i madh dasmash, bufesh, darkash e rastesh të kësaj natyre. Kam qenë edhe unë një herë i ri, ose jam përsëri i ri, sepse nuk ka shumë muaj që në inventar më regjistruan për 5000 lekë, por gjatë një beteje dasme u plagosa keq dhe tani imzot thotë se dola jashtë përdorimit. Ndoshta ashtu është, siç thotë ai, po unë çuditem si mund të dalë jashtë përdorimit një saks «fringo» pa mbushur vitin!?

Nejse, më mirë t'u tregoj për dasmën e fundit në të cilën dola në «pension».

Atë darkë imzot më mori si zakonisht dhe së bashku u nisëm për në dasmë. Shumëkush gjëzohet kur shkon në dasmë, por mua sikur nuk ma ka qejfi të shkoj. Jo se jam kundër martesave, por... nejse, t'i lëmë dëshirat personale dhe të tregojmë. Imzot, kur u afrua nga dyqind metra nga shtëpia ku bëhej dasma, takoi shokët e tij dhe unë të mitë. Motra ime,

klarineta, edhe këtë herë nuk mungonte, së bashku me kushërirë violinën e teze fizarmonikën dhe hallë kitarën me shokun xhez. Të gjithë, vetëkuptohet që ishin pronë e shtëpisë së kulturës. Pronarët tanë u hoqën mënjanë dhe filluan bisedën.

— Kush e ka bërë pazarin? — pyeti imzot dhe, meqenëse pazar i nuk qe bërë me të zotin e dasmës, e mori përsipër imzot ta bënte, si njeri më i rrahur në këto punë.

I zoti i dasmës na priti me të gjitha nderet.

— Erdhët, ëë? — na tha ai.

— Fjala, fjala! — u përgjigj imzot.

— Ju lumshin këmbët, po urdhëroni brenda!

— Më parë të merremi vesh! — tha imzot.

— Urdhëroni e flisni!

— Njëqind e njëzet lekë për shoq.

— Si shumë para, more shokëni. Po vetëm nja katër a pesë orë do t'u bini sonte...

— Shumë the? Jo, vëlla, nuk është shumë njëqind e njëzet lekë me këto vegla, që s'i ka kush në Republikë...

— Po sikur ta lëmë me njëqind lekë? — propozoi i zoti i dasmës.

— Sa? Njëqind?! Pse, ç'na bëre ti ne, endacakë? Ne kemi ardhur për hatër. Apo nuk i biem dhe me nota ne, nejse... ti vëlla, je dakord me njëqind e njëzet lekë për shoq?

I zoti i dasmës po shtrydhej, veç s'kish si t'ia bënte, se ftesat i kishte bëre me shënimin «*Kemi edhe saze*». Si të turpërohej para miqësisë?

— E po çfarë të bëj unë i varfri? — u dorëzua i zoti i dasmës.

— Të na trashëgohen!



Imzot me të zotin e dasmës u përqafuan. Pastaj ky i fundit u përqafua me të gjithë instrumentistët dhe, si mbaroi kjo ceremoni, shkuli portofolin dhe i numëroi në dorë gjashtëqind lekë tim zoti, i cili i futi në xhep duke thënë edhe një herë «Të na trashë-gohen».

Në tendën e dasmës rrinin ulur, pranë rakisë dhe pjatave, rreth shtatëdhjetë burra të moshave të ndryshme. Kur panë orkestrën, të gjithë u gjallëruan.

— Hej, mirë se ardhët, o ustallarë! Ju lumshin këmbët! E keni bërë si burrat. Do të bëjmë një goxha qejf sonte.

«Ustallarët» zunë vend si zakonisht te dera dhe shpejt e shpejt u gjendën të shoqëruar me faqoret e rakisë dhe me pjatat plot meze. Pastaj i hapën veglat.

— Ma jep një çikë do-në.

— Çfarë do, more? Lekët t'i dhashë një herë! — U hodh i zoti i dasmës.

— Nuk e kam me ty, po me shokët.

— Dooo...

— Faa...

— Këta qenkerkan sazexhinj me shkollë! — tha një plak.

— Janë të shtëpisë së kulturës, — sqaroi dikush.

— Mos, more? — u çudit i pari — Hë, më i lumtë atij drejtorit të shtëpisë së kulturës që do të na kënaqë sonte!

— Ore shokëni, keq nuk bën njeriu që pyesë. A nuk më thoni, si quhet ajo vegla që ka ai shoku atje, se këto të tjerat i njoh, — pyeti një plak përmua.

— Saksofon! — u përgjigj imzot.

— Si the zotrote, Ksenofon? — zgjati qafën plaku.

Të gjithë qeshën, vetëm mua më erdhi zor që më ndërruan emrin.

— Jo, Ksenofon por Saksofon.

— Për njëqind vjet nuk e qëlloj dot atë emër unë.

- Thuaj zurrna! — qeshi njëri.
 — E ke gabim, — korrigjoi tjetri, — zurrna i thonë gërnetës.
 — Atëherë thuaj tyrylyçkë!
 — Qysh, ore, t'i them kot tyrylyçkë?
 — Pse kot? Në fund të fundit, kur i fryn ky ustai, a bën tyryly-tyryly?
 — Bën.
 — Ashtu. Ti quaje tyrylyçkë. Apo jo, usta? — pyeti timzot. Imzot qeshi. Qeshën edhe dasmorët me emrin e ri që më vunë mua, saksofonit, mbretit të veglave frymore. Pa u shuar mirë e qeshura, një plak nisi këngën:

O bir, ku po na bien këto daulle?

*O tek Mite Sula në Bujan
e reeee..*

— Hajde ustallarë!

Dhe ne filluam.

— Ashtu, ore de, fryji tyrylyçkës, fryji mirë, se po i bie si në pesë puset. Vetëm një gjë nuk kuptoja: kur bënin prova në shtëpinë e kulturës donin një orë t'i gjenin telat, kurse në dasmë e kishin barutin të thatë...

— Ujë ore ujë... nga baxhaja. Në më ju lumtë, se do ta shkrijmë sonte fare, ohoho!

Dasmori që mori këngën u kënaq së tepërmë me orkestrën, prandaj shkuli portofolin e buhavitur, nxori një dhjetëlekëshe dhe ia ndezi në lule të ballit timzoti, sa unë i shpëtova nga goja, pastaj po me nga një dhjetë lekësh ua numëroi edhe të tjerëve, ndërsa or-

kestra u ndez «gjym» sikur të kishte tre muaj prova vetëm në këngën *O ku po na bien këto daulle*

— Si goja dhe zemra!

— Njatjeta edhe juve!

— Epo gëzuar, o vëllezër! Le të marrim një mirësi pér ustallarët, ju lumshin këmbët!

Gotat ndiqnin njëra-tjetërën dhe dasmorët u bë-në çakërqejf, bashkë me ta edhe ustallarët u bënë qejfllinj.

— O ustallarë! Pa na e merrni një herë atë *Nepërkën e shullërit* propozoi një, që kish kaluar me sukses shenjat e të dehurit.

— Nuk e dimë — u përgjigj imzot.

— Sus, qen bir qeni! — u nxeh i dehuri — Unë të paguaj paratë dhe ti do ta marrësh se s'bën.

— Nuk e dimë — tha përsëri imzot dhe më lë-shoi pér tokë pranë tavolinës. I dehuri u ngrit shula-shul dhe erdhi pranë nesh:

— Po në s'e di, mësoje, se prandaj të paguaj! O do ta marrësh *Nepërkën e shullërit* ti ose sonte do të shkojë gjaku në gju — ndërhyri i zoti i shtëpisë dhe i qetësoi gjakrat. Këtu ndodhi hataja.

Kur u ngrit i dehuri një shqelm e vuri në bar-kun e kushërirës violinë, që u hekuros menjëherë dhe një shqelm tjetër tek unë, që gjithashtu dola ja-shtë përdorimit.

Së fundi unë qaj hallin e rinisë sime, pa shtëpia e kulturës gjen përsëri të tjera. Veç nuk di nëse tim-zoti do t'i qajë xhepi pér mallin e shtetit apo jo?

I «ARRATISURI»

Në atë dhomë spitali, ku u shtrova për kurim, ndodhej vetëm xha Veliu, megjithëse dhoma qe katarshe.

— Shyqyr që më prure një shok, se u bëra derr këtu vetëm, — i tha infermieres që më shoqëronte. Plaku u çua ndenjur. — Tani rri sa të duash këtu... — xha Veliu heshti një çast, pastaj u paraqit:

— Unë jam Veli Shkoza, bari në kooperativën «Lumturia». Kam marrë një ftohmë. Kështu i them unë, kurse doktori i thotë një emër tjetër, që s'ia që-lloj dot, por më duket se fillon me brok, djalli e merr vesh punën e këtyre doktorëve. Se, që të pata llafin, këta doktorë dinë vetëm të shpojnë me gjilpëra. Apo nuk dërgojnë edhe nuse, sikur nuk ka për këto punë këmbë burri mbi dhe. Plaku u afrua dhe uli zërin. — Po pse, punë është kjo që t'u dëftesh grave të botës të ndenjurat faqe me nder. Dhe ato shejtanka nuk e kanë për gjë fare... Ja, kujto qenin... — Xha Veliu më tregoi derën prej ku u fut infermierja me shirin-gën plot dhe me një tampon me alkool. — Ju erdhi radha, xha Veli! — tha ajo.

Plaku u bind. U kthyesh përbys, uli pizhamet dhe fshehu kokën nën jastëk. Infermierja, si mbaroi punë, doli buzagas. Plaku u ngrit.

— Do të iki, pér nderin që ka burri, do të iki. Pse, punë është kjo? Të vjen gruaja e botës e të bën lëmsh?!

Xha Veliu shikoi nga unë, që tashmë kisha mbaruar së zhveshuri.

— Po ti, more shok, nga se u shtrove?

— Një sëmundje kemi, xhaxha.

— Ama edhe ti nga ajo djall bronko vuan? Lere mos e pyet, se pikën e zezë do të heqësh.

— Pse? — pyeta padashur.

— I ke bërë analizat ti?

— Jo.

— E nëne, nëne, ç'kam hequr unë! Këta doktorët veç mos të vënçin nën vetë, pastaj... plaku tun-di kokën, sikur donte të thoshte «Kjo kockë e di ç'ka vuajtur».

— Ushqimi si është? — pyeta.

— Ushqimi the?! Si në dasmë, po vetëm raki nuk ka. M'u tha e shkreta pér një pikë. I thashë një ditë infermieres të më sillte një shishe, po ajo ma preu bishtin në kërcu:


— Spitali ka rregullore, xha Veli! — Plaku preu fjalën dhe ngriti veshët. — Sikur po hahen andej nga korridori, — tha ngadalë. Dhe me të vërtetë zërat sa vinin e shquheshin.

— Ja, kështu si të them unë! — u dëgjua një zë i revoltuar burri.

— Në radhë të parë na duhet njeriu! — foli infermierja me të butë. Dera e dhomës u hap dhe u duk infermierja.

— Këtu jeni shumë mirë me xha Velion.

— Të ngroh vezë me xha Velion, thuaj më mirë. — Ai u ul pa na përshëndetur.



- Qysh je, more shok? — i foli plaku. I panjo-huri se ç'tha nëpër dhëmbë dhe ndezi një cigare.
- Ja edhe pizhamet! — Infermierja ia vuri mbi gjunjë. Ai i shikoi me neveri.
- Dhëndërr, dhëndërr do të bëhesh! — qeshi

përsëri plaku, ndërsa i panjohuri hoqi thellë duhanin. Infermierja doli.

— Nga se vuau zotrote? — e pyeti plaku.

— Nga asgjë! — tha shkurt i panjohuri. Plaku çakërriti sytë.

— Si asgjë, po përse ke ardhur këtu, apo të bësh llogje me mua? — I panjohuri shtrëngoi grushtet sa i kërcitën.

— Me siguri edhe ti atë bronkon ke, apo jo?

— Jo! — tha ai.

— Po, me sa di unë, nuk shtrojnë njerëz të shëndoshë në spital. — I panjohuri heshtte.

— Ku punon? — e pyeti plaku.

— Në brigadën e shpimeve të thella.

— Epo thuaj që atje je ftohur edhe ti.

— Janë ftohur mjekët! — tha me nervozizëm punëtori i shpimit.

— Dëgjo, more djalo, doktori muk na do të keqen, përkundrazi. Ja, më shikon mua ti? Kam dy javë shtruar, se mora një të ftohtë kur më zuri lumi dhëntë dhe po duroj gjithë ato gjilpëra, bashkë me thumbat e infermieres. Po pse, ore, ka lezet për mua plakun të nxjerr të ndenjurat me nder teje para syve të gruas së botës? Epo, mblidh këmbët o karkalec...

— Unë nuk jam i sëmurë! — nguli këmbë përsëri punëtori.

— Atë e di doktori! — i tha prerë plaku.

— Po punën time kush e di?

— Ti nuk je vetëm, është brigada...

— Ta dini ju se pusi është në avari...

— Hala nuk jeni shtruar? — pyeti rreptë mje-ku që u dha tek dera.

— Nuk jam i sëmurë.

— Atë e di unë! — nuk e la të vazhdonte mjeku.

— Po avarinë e pusit kush e di?

— Pér punën ka kush përgjigjet, kurse ti bëj atë që të thonë. Punëtori mori zjarr.

— Të bëj atë që më thonë?! Ti lë shokët në bal-të. Kulmi! Kam më sy e faqe...

— Ndoshta nuk është vërtet i sëmurë! — ndër-hyri xha Veliu.

— Ndoshta? Si ore, ndoshta! Nuk e di ti që mbrëmë ka punuar vetëm gjithë natën në ujë, në këtë të ftohtë? — Punëtori uli kokën si i zënë në faj.

— Nuk isha vetëm, me shokët... — belbëzoi.

— Edhe shokët i vizitova, por organizmi yt nuk i shpëtoi dot ftohjes, prandaj mos e zgjat.

— Po, po, mos e zgjat! — përforcoi plaku. Mjeku doli.

Punëtori u ngrit, zhveshi rrrobat e punës dhe veshi pizhamet.

— Mos është rrëzuar ai pusi yt? — pyeti plaku.

— Jo, i ka mbetur kolona brenda.

— Çfarë është kjo kolona?

— Tubat, sulinat!

— Aa! E mora vesh.

Erdhi dreka. Sanitaret që shtronin tavolinën po sillnin gjellët.

— Xha Veli, sot për drekë do të pimë dhe nga një gotë.

— Mos ia thuaj më emrin, se më pushoi zemra. Duke qeshur iu afroam tavolinës. Punëtori i naftës, me gjithë të luturat tonë, nuk vuri gjë në gojë. Vëtëm cigaret nuk i fikte fare. Edhe në darkë punëtori i shpimit të puseve nuk u afroa në tavolinë.

— Ej, çuno, mos ke ndër mend të shpallësh grevën e urisë ti? — Unë qesha, ndërsa punëtori zgjati dorën dhe kontrolloi paketën bosh mbi komodinë...

Në mëngjes xha Veliut i doli gjumi herët dhe më thirri:

— Çohu, more shoko! (Ai hala s'ma kish mësuar emrin).

U zgjova i tromaksur. — Ç'është!? — e pyeta.

— Ka ikur! — Plaku më bëri me kokë nga krevati bosh i punëtorit të shpimit.

— Ndoshtha është në banjë — i thashë me dyshim.

— O po ka ikur ai, është arratisur, çapkëni. Nuk i shikon, pizhamet që i ka lënë mbi komodinë?

— Me të vërtetë qënka «arratisur»! — thashë me vete.

Më vonë mësova, se spitali nisi një autoambulancë për te pusi, por nuk e muarën dot, mbasi punëtori i shpimit, me të parë nga larg makinën e bardhë, ia dha vrapi tatëpjetë përroit dhe humbi dushqeve. U kthye vetëm kur makina u nis përsëri andej nga kish ardhur.

Së fundi mësova se spitali kish dërguar një infirmier atje në pus, që i bënte mjekimet «të arratisurit».

TE RRUAT BLLOKU, SHOKU BRIGADIER...

Tre muaj kisha që isha transferuar në atë ndër-marrje. Nuk kam pse të lavdërohem, po tre muaj pu-nova si një kalë; jo se doja të formoja opinionin mbi personin tim, por s'di sepse e mora me shumë qejf atë kolektiv, ose ndoshta qe ky që më bëri të punoja derrce, kur thonë. Me një fjalë diçka e tillë ndodhi që mua më numëronin si një ndër punonjësit më të mirë.

Fill mbas tre muajsh, brigadieri ynë organizoi një mbledhje dhe me një bllok shënimesh në dorë, analizoi një për një punën tonë. Unë natyrisht prisja të lavdërohesha, po më mirë dëgjojeni vetë ç'tha brigadieri për mua.

... Shoku Konstandin ka ardhur i ri tek ne. Dhe kur thonë, i riu si veriu është... Konstandini është djalë i mirë. (Unë jam mbi 50 vjeç burrë). Nganjë-herë të duket sikur punon shumë, por në fakt ai nuk bën asgjë. Dhe në ato pak gjëra që bën tregohet kon-fuz, nuk është krijues. Shkurt, bën më shumë llafe se sa punë...

Për një çast shikova shokët, të cilët ulën kokën, dikush më luajti syrin, por unë nuk mora vesh as-gjë. Bile po dyshoja se mos isha në ëndërr, prandaj pyeta shokun që kisha pranë:

— Qemal! Pa shikoni mirë, välla, jam unë apo s'jam unë?

— Mos shiko se ç'je, por shiko se ç'do tē mbetesh pas fjalës së brigadierit.

— ... Shoku Konstandin éshtë i hedhur pak, por edhe qumëshти që ziejmë në tenxhere po u hodh pak del nga ena dhe nuk mblidhet më...

— Jo, nuk kemi tē drejtë tē...

— Ulu, djalo... Ju nuk bëni asgjë tjetër tan i vetëm vërtetoni ato që po them unë pér ju...

U ula. Këtu ndoshta isha nxituar. Brigadieri vazhdoi:

— Vendì që mbani ju, shoku Konstandin, éshtë vend pëllumbash, kur thonë, por unë jam i mendimit dhe besoj se bashkohen edhe shokët me mendimin tim, se në qoftë se në vendin tuaj do tē kishim vendosur një fëmijë që sapo tē kish mësuar abetaren do ta kryente më mirë detyrën...

Pra Qamili kishte tē drejtë. Unë, mbas fjalës së brigadierit, gjithmonë duke u bazuar tek ai, mbeta një... ose më mirë nuk mbeta asgjë...

— Me leje? — kërkoi fjalën Qamili.

— Nuk kemi mbledhje këtu, o shpirti im! — ia ktheu gojësheqer brigadieri. — Unë bëra një analizë tē shkurtër tē punës suaj. Kur tē kemi mbledhje, pyetni dhe diskutoni.

Mbledhja mbaroi dhe unë mezi munda tē gjej derën.

U hoqa veç dhe u ula s'di se ku duke vënë kokën midis dy duarve... Atë kokë që më ziente nga lloj-lloj mendimesh.

— Çohu, se u hap mensa! — Qemali më ftonte pér bukë, kur unë isha gati t'ia mbathja nga sytë këmbët.

- S'më hahet! — i thashë pa qejf.
- E a derëbardhë, përse merakosesh dhe ti!
- Më vjen inat, se është krejt e padrejtë.
- Vetë e ke fajin! — më tha Qemali papritur.
- Unë?! — u çudita.
- Po ti, kush? unë? Unë nuk u kritikova.
- Si? Edhe ti je dakord me mendimin e brigadierit, se unë nuk kam punuar? Po ne kemi qenë bashkë...
- Dale, dale, mos u nxito, se nuk thash që nuk ke punuar.
- Pastaj, çfarë?
- Ke bërë ndonjë «gjynah» tjetër.
- Unë?
- E mo ti, se më plase!
- Thuamë çfarë kam bërë, se më luajte mendsh!
- Ndoshfa ke kritikuar ndonjëherë brigadierin në ndonjë mbledhje.
- Po. Një herë në organizatën profesionale.
- Ç'tu desh, more Konstandin!? shejtani fle, ti vete e zgjon!
- Po ai më shtrëngoi dorën pas mbledhjes.
- Ja ke hequr vetes, të them.
- Po ai më përqafroi.
- Vetë me duart e tua shtrove ferra nëpër këmbë.
- Po ai më puthi në të dy faqet...
- I puthi atëherë, që ta harroje më shpejt.
- A thua me të vërtetë të jetë brigadieri ynë kështu?
- Gjë të shkruar në ballë nuk ka.
- Ai duket mjalt e sheqer! — i thashë shumë i çuditur.



— E njoh para teje unë...

Pas kësaj mbledhjeje mua nuk më bënин më duart pér punë. Paraqitesha në orar, sillesha téré ditën, pa kapur bisht pune, shokët shpesh më këshillonin, ndërsa unë vazhdova kështu edhe tri ditë të tjera. Doja të bëhej ndonjë mbledhje tjetër pér të larë hesapet me brigadierin. Shokët, duke më parë mua se po thyhesha kështu, më këshillonin dhe punën time pothuajse e kryenin ata.

Mbas tri ditësh brigadieri na mblodhi përsëri. Tani isha i sigurt se do të më dërrmonte. Po edhe unë isha pregetitur. Jo si radhën e parë. Me këtë bindje zura vend pranë Qemalit, që s'më ndahej pér asnjë çast. Brigadieri u çua, si tri ditë më parë, na hodhi një vështrim, bile mua më buzëqeshi, dhe pastaj nisi:

— Shokë! ne sot... — Unë nuk po e dëgjoja më, kaq indiferent isha bërë. Vetëm kur zuri emrin tim në gojë përqëndrova vëmendjen:

— ... Konstandini, shokë, po ia merr dorën punës, ka filluar të lëvizë më shumë se përpara. Po i futet më thellë detyrës së tij, shqetësohet pér të, mendon pér të, ndihmon të prapambeturit, merr pjesë gjallërisht në jetën e repartit...

— Shiko, shiko! Ose unë jam çmendur, ose këtij brigadierit tonë i kanë ikur burgjité! — i thashë Qemalit.

... Detyrën siç e kryen Konstandini, shokë nuk do ta kryenin edhe pesë të tjerë. Merrni shembull të gjithë nga Konstandini, u shkri në punë si...

— Jo, një mijë herë jo. Ju po gënjeni, shoku brigadier! — nuk durova dot më, po u çova në këmbë dhe e ndërpresa atë.

— Ç'thuas kështu, more Konstandin? Udhëheqja

e repartit ta çmon punën tënde, ndërsa ti tani po mohon djersën tënde.

— Unë nuk kam derdhur asnje pikë djerse këto tri ditë, kurse ti...

— Përsëri nuk po të kuptoj! — brigadieri ngriti supet.

— Në qoftë se dëshironi po shpjegohem tani, shoku brigadier. — Ju thatë se Konstandini po ja merr dorën punës, unë po ju them se në këto tri ditë ia kam prerë duart punës. Ju thatë se kam fillouar të lëviz. Unë po ju them se me siguri për tri ditë ka lëvizur toka, ndërsa mua s'më bënte zemra. Natyrish, për këto unë mbaj përgjegjësi. Por ama kritikës sate denigruese doja t'i përgjigjesha sa më parë, pastaj të mund të punoja si shokët. Ndryshe s'më bënin duart për punë. Shokët le ta gjykojnë vetë, po e vërteta kjo është.

— Më falni se po ju ndërpres, — ndërhyri brigadieri me ironi, — mos vuani nga ndonjë sëmundje psihike?

— Po, vuaj nga sëmundja e luftës kundra padrejtësive! — iu përgjigja unë me të njëjtën gjuhë dhe vazhdova:

— Tani së fundi, nuk di nëse do të më kritikoni më, meqenëse të kritikova...

Brigadieri u mundua të shpëtonte:


— Shoku Konstandin, unë nuk kam mbaruar. Në fillim ju vura në dukje anët e mira, tani do t'ju radhis edhe ca vërejtje të shënuara në bllok...

— Të rruat blloku, shoku brigadier! — iu përgjigj atij njëzëri kolektivi i repartit.

A I BIHET PLEPIT ME KOKË?

Një ditë, para se të fillonim punën, mua dhe Qenanin na thirri shefi në zyrën e tij. Të njihemi pak: unë jam disi gjaknxehtë, megjithëse asnijëherë nuk kam pasur temperaturë, kurse Qenani është «frigorifer», kur thonë. Vajtëm në zyrën e shefit.

- Erdhët ju? — pyeti ai, sikur të ishte i verbër.
- Erdhëm! — thashë unë, sepse Qenani e di shumë mirë kur duhet të hapet goja.
- Tani dëgjomëni, hapni veshët mirë dhe veproni ashtu siç u them unë.
- Si urdhëron, shoku shef — u përgjigja përsëri unë. Ndërsa Qenani nxori llullën dhe e tymosi zyrën e shefit.
- Sot ju të dy do t'i bini plepit me kokë...
- Çfarë?!... — s'm'u durua mua. Shefi mori zjarr si shkozë e thatë.
- E di që je në zyrën e shefit tënd?
- Si urdhëron.
- E di që këtu ke ardhur për të marrë urdhra?
- Po!
- E di që urdhri është urdhër?
- Si urdhëron! — u përgjigja unë, se Qenani kishte punë me llullën.
- Po atëhere, si mund ta marr unë kundërshti-



min tënd, kur unë nuk e kam dhënë plotësisht ur-dhrin?

Më gozhdoi kjo logjikë.

— Në qoftë se nuk ke mësuar të respektosh epro-rët e tu, thuaje, që ta dimë ne! — foli ai në shumës.

Tani që po e rikujtoj s'më besohet të jem nxehur aq shumë, sa ta bëja shefin të pinte një pako me aspirina dhe të lidhte kokën me peshqir.

— Shoku shef, t'i biesh plepit me kokë është vetëm e mundur për ndonjë shofer të dehur. Bile edhe ai nuk i bie me kokën e tij por me kokë të makinës. Kurse unë e Qenani nuk e bëjmë dot këtë gjë.

— Fol për veten tënde! — tha me ngadalë dhe qetësi Qenani.

— Si the?! Pse, ti je dakord, shoku Qenan, t'i biesh plepit me kokë?

— Secili ka kokën e tij dhe qëndron në këmbët e tij! — ma preu shkurt Qenani.

— Mirë atëherë, unë nuk i bie plepit me kokë.

— Do t'i biesh!

— Kurrë!

— Atëherë ti po thyen disiplinën shtetërore dhe po më detyron kështu të të pezulloj menjëherë nga puna.

— Si të doni.

— Jo si të dua unë, po si të thotë ligji.

— Ligji nuk thotë t'i bie unë plepit me kokë.

— Ligjin e interpretoj unë, ti je i detyruar ta zbatosh. Mbaruam bashkë.

Unë u ula. Shefi u kthye nga Qenani:

— Ju, shoku Qenan, e keni të qartë urdhrin?

— Jo vetëm të qartë, por shumë të qartë. Në goftë se më lejoni, shoku shef, që edhe unë të jap mendimin tim.

— Si jo? Unë gjithmonë i mbahem mendimit të masës, prandaj flisni pa druajte.

— Mendoj se duhet të zgjedhim një plep të madh që asnji para nesh të mos jetë ndeshur me të...

— Të lumtë, Qenani! Ti me të vërtetë shqetëso-

hesh për lavdinë e ndërmarrjes! — u entuziazmua shefi.

— Më parë duhet të vërejmë nga të fryjë era...

— C'punë ka këtu era? — u çudit shefi.

— Që edhe ne t'i biem me kokë, po nga të fryjë era, sepse era sado pak do të na ndihmojë.

— Gjeniale! — Bravo, Qenan! — shefi u kthyë nga unë: — Ja kush vret mendjen për punën e tij.

Qenani më shkeli syrin. Në këtë kohë (më kujtohet mirë) shefin e thirri drejtori dhe ne të dy mbetëm vetëm.

— Ti, Qenan, nuk je në binarë, — i thashë ashtu i nxehur siç isha. Ai qeshi.

— U plake e mend s'vure. Po ç'të duhet ty të kundërshtosh? Kur shefi thotë fluturoi gomari, ti thuaj që fluturoi dhe jo vetëm fluturoi po edhe se i vareshin litarët e samarit.

— Si? Kjo nuk është aspak e ndershme!

— Atëherë luaj me karrigen e shefit ti!

— Këtu s'ka punë karrigia, por... fjala më mbeti për gjysmë, se shefi nuk e bëri të gjatë te drejtori.

— Vazhdo, Qenan!

— Jam i bindur, shoku shef, se kjo punë do të çuditë të gjithë, prandaj të fillojmë menjëherë t'i biem atij qerrata plepi me kokë.

— Tani, shoku Qenan, do të shkoni në repart dhe do të interesoheni lidhur me ngritjen e kualitetit të atyre mobiljeve të sapopërfunduara.

Qenani doli, kurse unë isha gozhduar në karrige.

— Me ju mbaruam më parë, mund të shkoni!

— shefi po mblidhte shkresat.

— S'kam mbaruar unë me juve, shoku shef.

— Të kam thirrur unë ty në zyrë e jo ti mua. Se si m'u kthyë mendja që edhe unë t'i bija ple-

pit me kokë nuk e mora vesh. Veçse thashë të pro-
voja ,se mbasse, duke i rënë unë plepit me kokë, do të
dhimbte koka e shefit e jo imja.

— Shoku shef... më duket edhe unë sikur po-
e kuptoj se i duhet rënë plepit me kokë.

— Ashtu?! Kam thënë unë se ti nuk je aq gjak-
nxehtë sa të bëjnë.

— Pra ç'duhet të bëj?

— Një manovrim me cilësinë e mobiljeve të gat-
shme, asgjë më tepër. Nga e treta në të dytë, nga e
dyta në të parën. Ti i di më mirë këto punë, pasi je
kontrollor cilësie. Ik tani!

— Po sikur të mos iki? — e pyeta.

— Çfarë do të thuash me këtë?

— Atë që plepit mund t'i bie me kokë, por jo
kualitetit me këmbë!

— Fjala jote e fundit?

— Punë që nuk bëhet ajo, shef!

— Unë them se do të bëhet!

Ditën tjeter shefi përsëri na thirri në zyrë:

— Shokë! sot ju do t'i bini dushkut me kokë...

Kuptohet që ne nuk i ramë as plepit, as dushkut,
sepse kolektivi i ra arrogancës dhe kokëfortësisë së
shefit tonë bujëmadh.

Z H A B A X H I N J T È

— Juve, shok, punën në prodhim do ta kryeni në brigadën e zhabave! — më tha kryetari i kooperativës. — Atje jemi mangut me krahë pune.

— Brigada e zhabave?! — u çudita unë dhe qesha.

— Ti, shok, në qoftë se ke ardhur për të bërë punën në prodhim nisu ku të thonë, jo po, në qoftë se je drejtuar këtu për të qeshur, mund të shkosh nga erdhe.

«Mbase nuk është vendi dhe koha për të qeshur», mendova dhe e pyeta, si me frikë, këtë kryetar që edhe për të qeshur nuk të linte.

— Pooo... nga bie kjo brigadë e zhabave??!

— Nuk e dini ju se ku jetojnë zhabat? — maktheu ai.

— Më falni, po në zoologji kam qenë nxënës i dobët. — Ai qeshi dhe unë, pa menduar, zbardha dhëmbët.

— Jo, i dashur! Ti nuk e di ku jetojnë zhabat, shumë keq. Bile duhej thënë se është alarmante. Ti, shok, nuk e njeh fshatin. Derisa nuk di ku marrin frymë zhabat, nuk di aspak se ku jetojnë kafshët e tjera të kooperativës, pa le njerëzit, po nuk më thua, ç'detyrë bën atje në qytet?

— Nëndrejtor i uzinës!

— Aha! Paske të drejtë ti, se të qenkëshin dembelosur të ndenjurat në kolltuk... hëm... po sa vjet ke në atë vend?

— Një vit e gjysmë.

— Po më parë ç'punë ke bërë?

— Punëtor!

— Punëtor?!? — u çudit kryetari. Unë ngrita supet.

— Mirë. — Kryetari vuri stilografin në tëmbëlza, sikur të ishte çelës për të hapur kasafortën e urdhraise, pastaj mori një fije letër dhe shkroi: «Shoku Sulë! Letërprurësi do të bëjë punën në prodhim në brigadën e zhabave. Pranojeni. Të fala, kryetari: Loni Kodra».

— Merre këtë pësullë dhe drejt e te Sulua.

— Si urdhëron, po ku mund ta gjej?!

— Kanaleve vaditës, kullues, ose në rezervuar.

Dola nga zyra e kryetarit dhe eca në drejtim të një kanali ku gjeta një plak me lopën prej kapistrë.

— Tungjatjeta, xhaxha!

— Të lumshin këmbët, mor bir!

— Kërkoj brigadën e zhabave.

— Zhabaxhinjtë do ti?

— Po!

— Plaku u afrua:

— Mos je ti ai tekniku i zhabave?

— Jo, kam ardhur të punoj në atë brigadë. Plaku tundi kokën tërë thinja.

— Nuk është keq, se mbush xhepin, po... ai u përtyp... po ajo djall brigadë më tepër po bën zullum se qar... Nejse, nejse, mbarë t'u bëftë, se, që

thua ti, ne pleqtë ca gjëra s'i kuptojmë mirë... po ja, merr këtë vijën vaditëse dhe të nxjerr vetë ajo.

— Faleminderit, xhaxha!

— Mbarë tē vaftë!

U nisa anës kanalit me një varg mendimesh në kokë. «Kjo djall brigadë e zhabave ç'do tē jetë vallë?! Kisha dëgjuar pér «kompaninë e bretkosave», por këtu kisha tē bëja me njësi më tē madhe se kompania, me një brigadë zhabash dhe jo bretkosash. Me mendimet e mia ecte edhe uji i kanalit vaditës. Një zhabë u hodh nga ledhi në ujë, duke lënë në ajër një curril uji, si një shirit gazrash tē një aeroplani turboreaktiv. «Ndoshta kjo zhabë bën pjesë në atë brigadë», mendova.

Në krahun e djathtë tē kanalit, në hijen e një fiku, një plak tjetër bënte litar. I afrohem:

— Punë e mbarë, xhaxha!

— Mbarë paç e mirë se erdhe! Nga ju kemi?

— Nga qyteti vij.

— Pér kontroll, eë'??!

— Jo, xhaxha, kam ardhur tē punoj...

— More si nuk erdhi një herë një kontroll i fortë? — pyeti plaku.

— Ka kontolle më tē fortë se ju?

— E njeh kryetarin tonë ti?

— Jo, vetëm sot e pashë.

— E peeee?!!?... Plaku rrudhi sytë e vegjël dhe tundi litarin sikur tē shkundte kryetarin.

— Nejse, nejse... Po hele, hele, ç'e mirë tē solli këtej?

— Të bëj punën fizike.

— Mirë, bëje, po ku do tē punosh?

— Në brigadën e zhabave.

— Hëm, në brigadën e zhabave, po pse nuk ka

brigadë të arave, apo në ara po humbet yshyri, thuajti. E, pikë e zezë, ee! Edhe këta këtë brigadë kërkojnë.

— A do t'i gjej dot sot? — pyeta.

— S'e besoj! — tundi kokën plaku.

— Pse?

— Si përsë?! Ata flenë më ndonjë hije mani a fiku.

— Në valën e punës flenë ata?

— Po natën zihet ajo e uruar... zhabë, s'e ditë?... Një të vënë alitrikun në sy dhe zhaba «patak-set» nga aleti i «frëngut». I vë dorën dhe e mbërthen. Ajo bën nja dy herë gëk, mëk dhe hopa në thes.

U ndava nga plaku gojëmjaltë dhe nisa përsëri rrugën anës një kanali vaditës.

Në krahun e djathtë shtrihej një bllok me misër, që i kishte kaluar koha e shatit si ndonjë beqari dyzetvjeçar koha e mërtesës. Qante ara për një bisht shati. Në krahun e majtë gruri po jepte amanetin e fundit, por edhe këtë kryetari nuk e paskej vënë re.

— Prite, more Trifon, atë sylarushen, se pënder një gjysmë kile peshoka.

Ktheva kokën. Disa mjerëz hidheshin e bridh-nin pas një zhabe mbi orizore.

— O po zëreni maskareshën! — Zhaba e shkretë, e tromaksur, bridhte cep më cep katroreve të mbjellë me oriz. Katër burra azgënë, që edhe një luan do ta kishin bërë zap, i qenë lëshuar pas. Zhaba hidhej. Edhe ata hidheshin në «plonzhon».

Ja pra, brigada e zhabave! Këtë herë zonën e veprimit e kishte në orizoren, që sa kish jeshiluar. Si shkelën një dynym oriz, e kapën zhabën e lodhur.

— Amë të lumtë, o Miti! Ti duhet të jesh portier i kooperativës, që u hodhe pesë metra e drejt e mbi zhabë.



— Punë e mbarë, o burra!...
 — Mbarë paç! — u përgjigjën dy veta pa qejf.
 Dy të tjerët sa kthyen kokën.
 — Kërkoj brigadierin tuaj.
 Një kooperativist lëvizi, largoi trastën përgjysmë me zhaba dhe bëri përpara. Si u përshëndeta, i

dhashë pësullën e kryetarit. Ai e lexoi, pastaj duke rrudhur vetullat tha:

— Dakord jam të filloni, por kjo brigadë është e zgjedhur me kokrra... me një fjalë ju nuk e bëni dot këtë punë...

— Mos do zhaba ai shoku? — pyeti njëri.

— Jo, do të punojë me ne! — u përgjigj pa qejf brigadieri.

— Nuk pranojmë njeri tjetër ne, se na ulet ylefeja.

— S'kam çfarë të bëj. Edhe anëtarët nuk janë dakord.

— Vërtet nevojë kemi, po kundër kolektivit nuk dal dot unë. Bile sot u larguan nga kjo brigadë pesë anëtar, pasi thanë se po bënin më shumë dëme se sa punë. Ata, xhanëm, vetes ia bënë, mbasi unë u dola borxhit.

— Mirë, po ju pse bëni më shumë dëme se sa punë? — e pyeta?

— A, shok, të lutem! Shiko punën tënde dhe mos na u trazo në hesapet tona.

Nuk e zgjata. Duke u kthyer po mendoja. «Përse, vallë, nuk më pranuan zhabaxhinjtë! Përse, vallë, lihet buka e popullit arave dhe zihen zhabat? Pse ky organizim pune? Përse brigada e zhabave për një zhabë prish një dynym oriz?... Të gjitha këto pyetje vendosa t'ia bëja kryetarit dhe kryesisë, por kjo dëshirë nuk m'u plotësua, pasi një grupi i kontrollit punëtor dhe disa kooperativistë po e gozhdon te kryetarin me pyetje edhe më të forta, dhe kryetari nuk dinte nga t'ia mbante.

NJË HERË VDES NJERIU

Nuk mund të them se vdiq papritur, mbasi një plak që ka ngrënë njëqind e njëzet grazhdare, pritet të vdesë. Plaku shekullor vdiq pra duke iu nënshtruar kështu ligjit të rreptë të natyrës. Dhe ne u mblo-dhëm që t'i bënim nderimin e fundit, ashtu siç e kërkon nderimi i lashtë njerëzor.

Meqë u ndodha në fshat, shkova edhe unë në familjen e plakut. Në dhomë qenë mbledhur burrat më në zë të fshatit. Në të dy qoshet qëndronin dy pleq vërsnikë të të vdekurit. Herë-herë prishte qetësinë e përmortshme ndonjë fjalë e thënë me majë të buzëve ose ndonjë ngjarje që kishte të bënte me të vdekurin. Bile edhe ndodhia rrëfehej me «of» e «uf» nga tregimtari, i cili vinte në veprim të gjithë kujtesën dhe fjalorin e tij. Dikush tjetër përpiquej që të gjitha cilësitë e mira njerëzore t'ia vishte të ndjerit. Ne të tjerët miratonim me kokë ose thoshim ndonjë «po» si patericë për tregonjësin.

Ne ishim kthyer pra nga varrimi i plakut. Shumica, me gjithë të luturat e njerëzve të shtëpisë, nuk qëndruan për drekën e të vdekurit. Të tjerët, përmbi tridhjetë vetë, si dhe ne të largëtit, u ulëm. Kur hapej dera e dhomës, disa kthenin sytë nga ajo, me shpresë se po vinte rakia, që sipas zakonit, duhej të

hapte drekën. Por këto drekëra fshati ynë, e ndosh-ta edhe shumë të tjerë (përse t'u hamë hakun), mburren e mbahen më të madh lidhur se gjoja shprehin begatinë e tyre. Dhe ja, më në fund, erdhën shishet me raki rrushi dhe mezetë, mëlcji të skarës dhe kukurec të furrës. U renditën përpëra nesh. Ky qe si një dëshmi pér të pranishmit se i zoti i shtëpisë kishte bërë harxhet që kërkonte sëra dhe rasti.

E vërteta qe se një dash, pér të cilin u deshën dy burra ta varnin në degë të fikut, kish «thyer» këmbën dhe një shterpë gjashtë vjeçë, meqenëse nuk pillte, e shkuan në thikë.

Po le të kthehem te njerëzit, që me gota përpëra po prisnin nga qoshja te çelej dreka. Një plak me mustaqe drizë mori gotën dhe nisi ligjëratën e tij:

— Të dashur miq e shokë, të dashur vëllezër! Jemi mbledhur në shtëpinë e të ndjerit Vasil që t'i bëjmë nderimin e fundit duke hapur një të thelluar në kujtesën tonë pér jetën e të ndjerit Vasil. E ngre këtë gotë pér kujtimin e tij... Ndije zot shpirtin e tij! «Ndije!» u pasua koras nga ne të tjerët. Gotat u kthyen dhe disa pirunj u drejtuan nga pjata me kukurec. Mjaft nga të pranishmit nuk i prekën mezetë. Se nuk u jepoj. Por kishte tre-katër midis tyre që me vrull e vuillnet e plotësonin atë deficít.

Njëri prej tyre, filozofoi:

— Një herë vdes njeriu, o shokëni!

— Një herë — thamë edhe ne iu kthye shoku në krah.

— Të gjithë do të vdesim! — foli përsëri i pari.

— Ashtu është, fjalë e nderit.

— I ardhtë dheu lehtë!



— Amin! — gotat përsëri u kthyen.

— Kot sa prishim gojë njëri me tjetrin. Të gjithë atje do të përfundojmë.

— Të drejtë ke, ashtu është. Fjalë burri! — murmuriste një tjetër, i cili s'harronte të boshatiste shpejt

edhe gotat me raki edhe pjatat plot kukurec e mëlçi. Shumica shikonin dhe heshtnin, ose bisedonin me zë të ulët.

Sa kaluan gotat e treta, biseda mori zjarr.

— Ah, sa e hante kukurecin i ndjeri Vasil!

— Kiamet! — tha dikush dhe vazhdoi. — Më kujtohet njëherë kur po pinim raki në klub. Kukureci qe i palarë mirë dhe i ndjeri Vasil tha: «E sheh, o Qani... (sikur m'i ka thënë dje këto fjalë) E shikon, o Qani, këtë kukurec?

«E shoh» i thashë.

«Ja, kështu duhet të jetë kukureci, gjysmë përgjysmë i larë».

Pas disa gotash të tjera:

— Po, po ashtu hante ai — qorollisi njëri andej nga dera, që s'i kish dhitë në terezi.

— Jo hante ashtu, po hante kukurec të pjekur ashtu! — u nxeh ai që tregonte. — Ti, shoku Lamçë, pi rakinë dhe jo trutë.

— Ngadalë, burra, se nuk jemi mbledhur përt'u grindur, — i qetësoi plaku i qoshes së djathët. — Hajde, ngrini gotat!

— Ta pimë për kujtim të të ndjerit Vasil.

— Ta pimë!

— Qe burrë i mirë shumë.

U përcuallën kështu gotat e pesta. Dhe gotat qenë goxha të mëdha dhe gramatura nuk i nënshtrohej asaj të klubit. Pra s'duheshin më shumë përt'u «nxehur» muhabeti. Ata që pinin kështu tashmë ishin djersirë dhe bisedonin lirisht, bile edhe me passion, por pa i lënë mënjanë gotat dhe shishet.

— Që thoni ju, mëlçitë i ndjeri Vasil i hante, ose më saktë, të linte pa pjesë, — vazhdoi Lamçja duke marrë një thelë mëlçi nga pjata.

- Mos ia këput qorres ti, se Vasili nuk hante mëlçi.
- Hante.
- Nuk hante, të thashë.
- E mirë, e lëmë në tënden, po ai hante dhe bille ta merrete nga dora.
- Lere ku të duash ti, po të lutem shumë mëlçi mos i jep shokut Vasil.
- Pse mos t'i jap? — pyeti Lamja.
- Oj, pse thotë, po nuk e di ti se Vasili vuan nga mëlçia.
- Epo, gëzuar atëherë, shëndetin e parë e marrim pér Vasilin. Të shkuara i qofshin, shëndet e bereqet...
- Mendjen në teneqet. Po Vasili vdiq, o trush-kultur!
- Si, si the? — pyeti Lamçja i bërë tapë.
 - Vdiq, ore, vdiq.
 - Kur?
 - Ditën e mërkurë!
 - Tëënjen, më duket...
 - Jo, qe e martë!
 - Mos u tall, se Vasilin e dua më shumë nga plakun tim.
 - Vdiq o vdiq, i shkreti. Aq e pati.
 - More, more! Ai, i varfri, ka qenë balli i burrave!
 - Ka qenë, more shoku Lamçe, po nuk është më.
- Kur mori vesh Lamçja se Vasili jo vetëm që nuk qe më, por edhe nuk i jepej mundësia të kthehet, i ranë lotët si kokrra rrushi të bardhë dhe ia mori kujes me ngashërim:
- O Vasil, si na le, o Vasil, oooiii, oooiii.

— Të kisha në këmbë të babait, oooiii, oooiii!
Një tjetër, që ishte dehur më shumë nga Lamçja, ia pasonte kujën, po ashtu.

— Qysh na le kështu, o Vasil more, ooiii!

— O po me cilin do të loz domino, oooiii!...

— Ç'bëni, more! — thirri plaku i qoshes së dja-thëtë — çfarë dreqin jeni: burra apo gra? Ai një herë vdiq, kurse ju...

— Aman, xha Trushi, më këputi shpirtin, ky Vasil.

— Pushoni, se na turpëruat! — ndërhyri qosheja e majtë. Ata pushuan. Për dhjetë minuta krodhën gotat njérën pas tjetrës me fund duke e shoqëruar rakinë me mishin e pjekur, të ngrohtë, të sapodalë nga furra, pastaj Lamçja, që ishte bërë më xurxull nga të tjerët, mori gotën në dorë dhe e ngriti lart:

— Gëzuar, o vëllezër! Në të tilla gëzime...

— Ç'gëzime, mor trutapë! — e qortoi plaku i qoshes së majtë. — Ku e ke gëzimin sot ti?! Shikon ç'bëhet këtu apo vetëm të rrufitësh raki di ti?

Njëri nga nipërit e të ndjerit Vasil u nxeh shumë me Lamçen, po meqë e kishte në shtëpi e fali. Por Lamçia nuk donte ta falte. Megjithatë, ne e bëmë zap. Lamçia, nga inati, ktheu rakinë dhe theu gotën. Të shtëpisë bënë sikur nuk e panë.

Aty nga fundi i drekës, ata katër-pesë që pinin, e trashën shumë. Një palë grindeshin, ca flisin lloj-lloj qyfyresh me zë të lartë dhe qeshnin. Dy veta ia muarën një gjumi, të ngopur e të kënaqur nga dreka. Ndërsa Lamçja u kujtua prapë për grindjen me nipin e të ndierit. Dhe, meqë nuk e lanë të grindej, ai u çua dhe doli në derë e përjashta. Qe e kotë ta mbaje dhe askush nuk e mori atë mundim.

Ndoshta kjo gjë atij nuk i pëlqeu fare dhe, si e pa
që askush nuk po e luste për të qëndruar, ia mori
këngës pa e kthyer kokën pas:

*O mos ma bën me dorë, moj,
Pa folëm me gojë,
Se na shohin bota,
Kushedi se ç'thonë... Aeee...*

ZANATI LIHET ME SHPIRTIN

Xha Muçon ju nuk e njihni dhe s'keni si ta njihni, sepse kohët e fundit e ka lënë zanatin. Nuk e la se nuk e ushtronte dot, por pse fshatarët ia hoqën «diplomën» në një mbledhje. Në qoftë se doni ta dini çfarë zanati ka Muçoja unë jua tregoj. Xha Muçoja ishte shkësë, lajmës, ose ndërmjetës. Me një fjalë stiste fejesa, bile i rregullonte për mrekulli. Çupatona të fshatit nuk di sepse, sa herë shikonin plakun, kthenin rrugën, si ato thëllëzat nga zagari i gjahtarit.

Xha Muçon nuk e kisha parë ndonjëherë në shtëpinë time, prandaj u çudita kur bastuni i tij trokiti në portë.

— Mirë se erdhe, xha Muço! Të lumshin këmbët!

— Mirë se të gjeta, djalë i xhaxhait... Mirë e the të lumshin këmbët... po... po, bukur e the, se xhaxhai ka këmbë të mbarë. Këtë e dinë të gjithë, paçka se tani rinia na ka dalë me ojna të reja, por ama ti i ke ngjarë tyt eti, ndjesë pastë! Edhe ai ka qenë burrë zakoni, që, kur jepte fjalën...

Xha Muçoja nuk pushonte, ndërsa unë vrisja mendjen se ku donte të dilte plaku zakonlli.

Plaku nuk vonoi; hyri në temë menjëherë.

— E njeh djalin e Llazit ti?

— Si jo, jemi vërsnikë. Plaka më ka treguar se

ai lindi ditën e martë, unë të mërkurën. Domethënë i ka mbushur të dyzetat.

— Jo, more! — u thartua plaku. — Dëgjo xha-xhon ti, kur njeriut i mbylllet fati e para e punës mileti i rrit moshën e pastaj i ngjit bishtrat me radhë. Vetëm një gjë dimë, që është djalë shpirt njeriu, kur thonë.

— I mirë është, po është pak i «leshtë»! — thashë siç kisha dëgjuar.

— I leshtë the?! Jo, more bir. Dëgjo plakun ti, ai vetëm që nuk shikon mirë nga njëri sy, por edhe kjo nuk prish shumë punë. Se me një sy shikon Stambolin, po të duash. Or po, ç'më duhet më shumë kur shikon si të gjithë insanët... Tani, or bir, një ndihmë të vogël dua nga ti.

— Urdhëro, xha Muço. Po të jetë e mundur nuk do ta kursej.

— Ashtu, më rrofsh!... Ti çupën e Sotirit e njeh, apo jo?

— Si jo, pothuajse e kam rritur në prehër.

— Jo, more, në prehër! — u thartua përsëri plaku — se ajo është gati-gati moshatare më ty.

— Ç'thuas kështu, xha Muço? — kundërshtova unë.

— Ju të rinjtë keni dy gjëra të këqija, — u shtrua plaku në bisedë. — E para, që i merrni gjërat rrëmbyer, domethënë vini shtatë hunjë, kaloni një purtekë dhe e nxirrni gardhin përtej... ashtu de... E dyta, gjërat me leverdi i kuptioni vonë, ose, më keq, nuk i kuptioni fare...

Unë e ndjeva që xha Muçoja donte të përfundonte një mblesëri, këtë e mora vesh, po se ç'ndihmë kërkonte nga unë, as që i bija fare në të.

— Që ta pata fjalën, kam qenë te Sotiri nja dhje-

të herë pér t'i bërë çupën te çuni i Llazit, por ai nuk dëgjon.

— Po çupa, e do? — e pyeta unë.

— Ti më duket se nuk e njeh Sotirin. Sotiri është nga ata burra që t'i numëron dhëmbë e dhëmballë në dorë.

— Jo, nuk e njoh mirë, se është edhe larg nga fshati ynë u shfajësova, po, me sa di, vajza e Sotirit është si yll dhe kam frikë se nuk do të dëgjojë pér djalin e Llazit.

— Vajza shkon ku ta çojnë, pastaj atje ëmbëlsorhet ajo.

— S'ma ha mendja.

— Dëgjo xha Muçon, ti. Po të tha xhaxhai, kësh- tu do të dalë!

— Çfarë ndihme do nga unë? — e pyeta.

— Të vish me mua te Sotiri.

— S'marr vesh fare nga këto gjëra, xhaxha. — Janë punë me spec, doja të thosha.

— Muhabetin e dredh vetë unë, kurse ti do të përforcosh fjalët e mia.

«Mos do t'ia mbushësh mendjen me të vërtetë Sotirit», mendova, dhe aty pér aty vendosa:

— Na qoftë e hajrit, xhaxha.

Plaku u gëzua shumë. Më rroku në qafë dhe më tregoi një mesele që edhe gjyshërit tanë na ishin nisur një herë e një kohë pér mblesëri, kështu si ne, dhe u kishte dalë pér mbarë.

Sotirin e gjetëm në shtëpi. Ai e shikonte xha Muçon me bisht të syrit, ndërsa mua me gojëhapur, sikur donte të thoshte: «Mirë se këtij i janë thartuar trutë, po ty, more jezit, nuk të dija se bëje kësi punësh». Meqenëse i kishte thënë disa herë Sotirit pér çupën, xha Muçoja, nuk i erdhi më rrotull temës, po u fut në të si derri në arën me misër:

- Si e ke punën, o Sotir?
- Si s'ka më mirë! — qeshi hidhur Sotiri.
- Do ma japësh çupën ti, apo jo?
- Jo! — tha shkurt Sotiri.
- Po pse, mos kujton se të do të keqen Muçoja ty?
- Jo! — tha përsëri Sotiri.
- Mirë unë, se u plaka e më lanë mendtë, po shoku Koço, që la një tufë pune dhe erdhi me mua, mos e kanë lënë edhe këtë mendtë?
- Jo! — tha prapë Sotiri, duke shikuar me inat nga unë.
- Epo hajt, pra, jepe fjalën, se nuk ta duam të keqen. Sotiri po lëkundej. Xha Muçoja e nuhati gjahun që u trullos.
- Familje për kokë të familjes, me nder e me nam. Apo nuk kanë bërë një palë shtëpi të reja që bëjnë katërqind mijë lekë!
- Tetëqind mijë më duket! — fola si me dyshim unë.
- Hë më të lumtë, more Koço, se ti e di mirë.
- Po e di ti q'i thonë një shtëpie tetëqind mijë lekë? Kur një familje merr guxim edhe bën një shtëpi tetëqind mijë lekë do të thotë se edhe tetëqind mijë të tjera i ka vënë palë aty. Tani e kuhton ti, more Sotir, se jot bijë, po të shkojë atje, duhet të flerë në jastëk të mbushur me mijëshe.
- Jo vetëm jastëkët por edhe dyshekët! — e përforcova unë. Plakut iu bë qejfi.
- Hë më të lumtë, o shoku Koço! Ti i thua gjërat pa i zbukuruar fare. Jo po nuk do Sotiri që të çojë çupën në derën e princit. Apo nuk më ka një lopë, për kokën e lopës. E di shumë mirë, se e bleu

vjet me mua nē Luz dhe jep njëzet litra qumësht nē ditë.

— Sikur jep dyzet litra, o xha Muço!

— Hé mē tē lumtë, o shoku Koço! Ti duhet ta dish mē mirë, se je heqim pér lopët ti, ia thuaj Sotirit, a ka ndonjë sëmundje lopa e Llazit?

— C'është ajo fjalë!

— Lopë treviçash, apo jo, o shoku Koço?

— Me sa di unë është gjashtë viçash.

— Jo, more Koço, pér kokën tënde, se i ngatërroni ndonjëherë ju doktorët me ato qitapet tuaaja!

Unë i shkela syrin Sotirit, i cili më kuptoi mirë dhe u gjallërua.

— S'më duhet lopa mua, më duhet djali...

— Pér djalin e ke hallin ti! Po ka djalë më tē mirë nga ai i Llazit, i zgjuar, i urtë, punëtor, i pa-shëm, trim, i sjellshëm, apo jo o shoku Koço?

— Është i madh nē moshë, o Muço vëllai...

— Kush e tha, kush e tha, që ju thaftë gjuha që nē rrëzë! Nuk e di ti që djali është aty rrrotull tē njëzetave, apo jo, more shoku Koço?

— Ashtu është, rreth tē dyzetave...


— Mblidh mendjen Koço, se na ngatërrrove lëmsh. Sotiri ia plasi tē qeshurit. Xha Muçoja u nxeh.

— Thoni si tē doni, po djali i Llazit është pér kokën e djalit. Me shtëpi e pasuri, me pamje e zgjuarsi. Çupa jote, kur tē vejë nē atë shtëpi, do tē lërë mendtë. Mendtë, ore, mendtë, nga gjithë ajo kamje...

— Mirë o mirë, po nuk më thua pér çunin e Llazit, që gjer tanë na e nxore qelibar, s'paska ndonjë cen fare ky njeri, se insan pa noksan nuk ka, apo jo, o Muço?

— Ka, si nuk ka!

— Pse nuk e thua?



- Kur tē vijë sëra do ta them, apo jo?
- Po.
- Ç'do atëherë që më thua.
- Thuaje, de!... Ç'cen ka?
- Ta them, ore, si jo?.. Hëm... Çuni i Llazit, që thoni ju, vetëm një cen ka. Pse t'ia fshehim? Atë

ia ka dhënë perëndia... vetëm se nuk shikon ca nga njëri sy, apo jo, o shoku Koço?

— Ashtu është, por më duket se s'para sheh nga të dy.

Këtë herë Sotiri s'u mbajt më, por ia dha gazit sa iu shkallmuani brinjët. Bashkë me të qesha edhe unë. Xha Muçaja u çua më këmbë, sikur të ishte djallë njëzetvjeçar.

— Ka faj kjo kokë, që ulet në kuvend me kalanjtë... Hy, mos ua pafsha bojën!

— Ti, po deshe, mos na e shiko, more xhaxha, po ne do të ta shikojmë edhe një herë në mbledhjen e fshatit.

— Kot nuk thonë se zanati lihet me shpirtin! — tha Sotiri, dhe më zgjati kutinë e duhanit.

L E T È R . . .

Zaten unë nuk i «qullos» gjë letrat. Jo se nuk shkruaj dot asnjë fjalë, po se nuk di si e ke oreksin ti, pasi m'u duke djalë nga një xhins i çuditshëm e fort i rrallë. Sidoqoftë, po qe se nuk kam katranosur gjë, ti vëlla mos e lexo. Them mos e lexo, por unë kam vendosur të të shkruaj, duke pasur besim se ti, si djalë i ri që je, nuk do ta lësh pa lexuar... E mbasë do ta lexojnë edhe të tjerë, se edhe kjo ka rëndësi.


Nejse, unë do të shkruaj si di. Ne të dy u njo-hëm në një vagon treni, ditë e diel ka qenë, më duket, mbasi vagoni qe plot e pérplot, dhe unë qëndroja pranë teje më këmbë. Mua s'më vinte aspak rëndë që ti rrripe ulur, pavarësisht se je nja tridhjetë vjeç më i vogël nga unë. Nuk di si të vinte ty, pasi as të pyeta fare atë ditë. I thonë një fjale të urtë: «Kush mungon bluan». Edhe ti, apo erdhi treni, ia dhe vrapi për të zënë vend. Por meqenëse dyert qenë të zëna nga pasagjerët që zbrisnin, ti u fute fishek nga dritarja. Unë qesha, bashkë me ata që të panë. Vetëm se ne nuk qeshëm me ty... jo i dashur. Ne qeshëm pasi hyrja jote nga dritarja më kujtoi maçokun e shtëpisë që, sa herë gjen derën të zënë, futet nga dritarja. Për veten time nuk e kam provuar

hyrjen nga dritarja, qoftë edhe atëherë kur kam dashuruar time shoqe, në të ritë e saj. Ne, që po vrojtonim akrobacinë tënde, thamë se ti do të kishe ndonjë punë me axhele dhe nuk na shkoi mendja se ti kishe marrë lejen dhe shkoje në plazh, për të pushtuar. Kur e mora vesh thashë: «Epo, ndryshon puna, njeriu kur ka kohë të lirë lirohet edhe nga rregullat e edukatës dhe të mirësjelljes». Pra, ti, si i lirë që ishe, të jepej «e drejtë» jo vetëm të futeshe nga dritarja e vagonit, por edhe nga baxhaja, sikur vagonët të kishin baxha.

Treni ecte dhe ti përparoje në shfrytëzimin e kohës së lirë... Ia more këngës ose, po, të rrимë shtrembër e të flasim drejt, hape më parë «transistorin», ku u dëgjua një çirrmë, të cilën e quajte këngë, megjithëse mua më kujtoi më tepër ulurimën e një qeni të tërbuar se sa një këngë. Nejse, tek e fundit edhe unë e kuptova se këndohej një këngë nga ndonjë skizofren, të cilin ti e quajte këngëtar virtuozi. Ti thua virtuozi, ndërsa unë vë duart në zjarr se ai këndonte në çmendeninë dhe duhet ta kenë inci-zuar që poshtë dritarës me hekura të trasha. Them unë de! Nuk kuptova se si, pas pak, ti fillova ta këndoje bashkë me «transistorin», me aq pasion, sa unë thashë se do të binte të hollët. Por ti konku-rove denjësisht me transistorin, aq sa, po të isha unë, nuk do ta hapja fare radion. Besoj se të kujtohet shumë mirë kur pasagjeri që kishe përballë të tha: «Ka mundësi ta ulni pak zërin, mbasi kam dhe-mbje koke?» Dhe ti iu përgjigje:

— Të lutem shumë, shok, në qoftë se ke dhembe koke paraqitu tek mjeku i posaçëm për këtë hall dhe kurohu e mos udhëto! Unë kam qejfin tim...

— Dhe kështu është, vëlla, secili ka qejfin e tij,



Ti, për shembull, ke qejf të këndosh, ai tjetri ka «qejf» t'i dhembë koka dhe mua plakut më ka hipur qejfi të nusëroj më këmbë para teje.

Vetëm për një gjë m'u dhimse, megjithëse ç'faj kishe ti, një djalë pëllumb, veshur e ngjeshur sipas «modës», si asnjë nga moshatarët e tu! Si nuk t'i hidhte një herë sytë ajo vajza që ishte para meje më këmbë? Dhe tani çuditem si nuk e tërroqën atë vajzën «hyneret» e tua, kur ndonjë nga vagoni të mori si një këngëtar e artist? megjithëqë vendi nuk qe për shfaqje dhe ne s'kemi të tillë artistë.

Aty nga fundi i udhëtimit se si ta prishën humorin. Por, ama, edhe ti i fortë paskëshe qenë. Menjëherë u tregove grushtim atyre që të prishën qetësinë. Pra pëllumb djalë: me mend në kokë, me një zë që bëre goxha zhurmë në gjithë vagonin, por ama edhe fizikisht i pregetitur, megjithëse pati edhe më ustallarë nga ti!

Paske qenë njeri me të vërtetë me talent, por nuk më erdhi hiç mirë që «talentin» e rrallë nuk e ushtron edhe atje në ndërmarrje ku punon ose në lagje.

Tani së fundi dua të mbyll letrën, po nuk di ato të shkreta rregulla të mbylljes së letrës. Megjithatë çdo gjë që fillon edhe mbaron, pavarësisht si mbaron. Po e përfundoj me të fala, se kështu më duket më e udhës. Në radhë të parë, i bëj të fala babait tënd, i cili kujdeset kaq shumë për «talentin» tënd, duke i thënë njëkohësisht se djem si ti i kemi të rrallë, bile shumë të rrallë. Pastaj u dërgoj të fala gjithë shoqërisë sate, që me siguri janë shumë të rrallë edhe ata dhe aty e aty me mendtë e tua të bukura. Hidhu ndonjë fjalë nga këto edhe andej nga qendra e punës, se mbështetës s'ta marrin për keq.

FQINJÉT NË GARE

S'di si ndodhi që dy fqinjë të mirë u zunë, u grindën dhe më në fund u zemëruan me shoku-shokun. Gjer këtu mendoj se s'ka asgjë të jashtëzakonshme, pasi raste të tilla ka pasur e do të ketë. Vetëm mëria e dy fqinjëve kishte diçka të veçantë, që në fillim nuk na ra në sy. Ishte çështje gare!

Njëri nga fqinjët bleu një bicikletë. Kush i tha mos ta blente? Nuk vonoi shumë dhe fqinji tjetër bleu dy bicikleta: një të kuqe, një të zezë. «Epo, punë shijeje» thamë ne. Mendoam se njëren e mori për gruan, po të dy bicikletat qenë burrash. Kjo na çuditi pak në fillim.

Më parë, për të mos ngatërruar lexuesin, t'i emërojmë fqinjët e mirë. Njërin e quanin Lame, tjetrin (atë që bleu dy bicikleta) e thërrisin Xhezo. Tani Lamja, duke parë se Xhezoja ia kaloi në garën e bicikletave, mori një motoçikletë. Këtë herë të gjithë qenë të mendimit se Lamja e fitoi garën, por s'doli ashtu, se Xhezoja bleu menjëherë një triçikël dhe, si hipi gruan me gjithë fëmijë, i bënte xhiro Lames para ballkonit. Lamja u tërbua fare. U çua dhe mori me qira një taksi «fringo». Gjer këtu u ndërpore gara e transportit, se po të kish vazhduar më tej, fqinjët tanë do të kishin kërkuar ndonjë ani-

je kozmike. Kjo garë, përveç argëtimit publik, nuk pati asgjë të keqe.

Menduam se kaq e pat kjo punë dhe Lamja me Xhezon do të pajtohesin përsëri. Por ne ishim gauar.

Kur menduam kështu, filloi gara tjetër, ajo me radio. Po, po, garë me radio. Shenjën e fillimit të garës e dha Xhezoja. Një darkë, kur Radio Tirana transmetonte këngë labe, ai e hapi volumin e radios deri në fund, gjithashtu s'la pa hapur edhe derën e ballkonit të apartamentit. Lamja, sa dëgjoi sfidën e fqinjët, shkoi menjëherë te radioja e tij dhe e hapi.

— Këndo, moj mortje, hape tytën! — i fliste ai radios, që ende nuk i qenë nxehur llampat. Filloi kështu furishëm gara e radiove. Radjoja e Xhezos, veç zërit, jepte dhe një gjerr-gjerr, thua se po shtypeshin qindra kokrra arra, kurse e Lames kishte një fishkëllimë të gjatë si të një lokomotive me avull. Para pallatit të Xhezos e të Lames u bë vend shumë shqetësues për kalimtarët. Edhe ndonjë kokë-krisur, që rastiste, zinte veshët fort me gishta dhe pesëqind metro i bënte në pikë të vraptit, sa po ta shihte ndonjë trainer atletike do ta kishte marrë pa asnjë provë tjetër.

Kjo garë vazhdoi plot dy muaj. Me siguri lexuesi është kureshtar të dijë përfundimin e garës. Në fakt, si çdo fillim që ka një përfundim edhe fundi i garës së radios u mbyll me rezultate të hatashme: dy radiot nuk duruan dot më, por u dogjën me llampa, me transformatorë e me tela, ndërsa kutitë e radiove u adaptuan për të rritur pëllumbat.

Kaloi një periudhë qetësie prej afro dy javësh. Kalimtarët e asaj rruge u gjëzuan që u dogjën të dy radiot. Por garat ndiqnin njëra-tjetrën, pothuajse pa


ndërprerje. Një ditë në ballkonin e Xhezos u gjend një fuçi mbushur me dhe, ku qe mbjellë një rrënë hardhi. Lamja nuk e bëri të gjatë, po mori s'di ku dy fuçi dhe mbolli një hardhi dhe një portokalle. Xhezos iu desh të marrë edhe një fuçi tjetër, të cilën e mbolli me një rrënë limoni. Kështu rezultati i garës vajti dy me dy në favor të ballkoneve. Pra gara e ballkoneve nuk u pre, përkundrazi ajo mori edhe më zjarr kur në ballkonin e Xhezos u shtua një koshere bletësh. Në këtë kohë Lamja u zhduk nga qarkullimi, bile edhe në punë nuk shkoi. Kur u kthyte me një koshere bletësh dykatëshe, atëhere të gjithë thanë se Lamja me të vërtetë qe pjesëmarrës i denjë i garës së ballkoneve dhe tifozët e Lames qenë shumë optimistë në fitimin e garës. Dhe me të vërtetë Lamja e çoi më tej stafetën e garës duke i shtuar ballkonit të tij një dhi e një qen.

Xhezoja gjeti një qen stani dhe një derr të buttë. Këtu u ngatërruan punët, sepse qeni, siç dihet, nuk shkon me derrin, pavarësisht se derri është kokëtrashë.

— Ç'bëni, more, botën do të ndani që ziheni? Turp, o, turp të keni.

Një ditë derri, duke u kruajtur, rrëzoi nga ballkoni i katit të tretë kosheren e bletëve, e cila sa ra në trotuar u nda copë e thërrime. Bletët u hardallosën dhe nuk lanë njeri e kafshë pa thumbuar. Bile qeni i Lames u hodh nga ballkoni pa parashutë, pa pësuar asgjë dhe ia dha vraptit nga e çuan këmbët.

Ky qe dështimi i plotë i Xhezos në rritjen e kafshëve në ballkon, prandaj u dha vetëm pas frutikulturës, sidomos me rritjen e hardhisë. Po edhe Lamja nuk e hante thatë, Në ballkonin e tij po shtoheshin



fuçitë e mbjella me gjithfarë bimësh. Me një fjalë gara e ballkoneve vazhdonte me sukses.

Në fillim u duk se gara nuk do të përfundonte kurrë, por ajo përfundoi papritur dhe me një rezul-

tat të thellë. Dhe ja si ndodhi: Një mëngjes, kur të dy fqinjët e mirë po vadisnin bimët e tyre të dashura, ballkonet nuk mundën më që të mbanin sipër fuçi të tilla. Natyrisht faji qe i inxhinierit projektyes, që nuk i kish shkuar mendja se banorët mund të merreshin edhe me bagëti e me bujqësi. Ballkonet u këputën njëri pas tjetrit. I pari ai i Xhezos me gjithë të zotin dhe pas tij ai i Lames me Lamen në krye.

Të dy fqinjët u gjendën shtruar në trotuar: Xhezoja theu një brinjë, kurse Lamja dy gishtërinj. Tani janë në spital pothuajse të shëruar, por ende s'kannë dalë, pasi pritet të shërohen edhe nga koka...

SHËRBIMI I BARKUT

Ne ishim dy: unë dhe Suloja, të dy shoferë dhe po të dy me «shytë». Ndaluam para një rostiçerie dhe menduam të hamë darkë. Menduam ne, por...

Më përpara duhet të kisha thënë se nga shtëpia dola në orën tre të mëngjesit dhe nuk më hapej goja. Në drekë nuk qëndruam gjëkundi, sepse ngarkesa jonë pritej me padurim. Me një fjalë unë me Sulon i mbushëm njëzet e katër orë pa ngrënë. Suloja mbahej me shtresat e dhjamatit, mbasi pesha e tij ka nxjerrë tri herë jashtë përdorimit sedilen e «shytës». Kurse unë jam gjashtëdhjetë kile burrë, prandaj dhe më merr më shpejt uria. Stomaku dhe zorrët cirreshin për padrejtësinë që u ishte bërë.

- Shoqe, të lutem na faturo, se po jap xhanin!
- i thashë seriozisht dhe nxora të hollat.
- Kuzhina éshtë mbyllur! — tha ajo ftohtë.
- Pse? — pyetëm ne me një gojë.
- Ka dalë kuzhinieri! — tha ajo qetë-qetë dhe iu fut një shumëzimi.
- Ku? — mundi të pyesë Suloja. Ajo nuk u përgjigj.
- Do ta presim! — vendosëm.
- Kë do të prisni ju? — pyeti arkëtarja.
- Kuzhinierin.

— Ai do të vonohet!

— Moj shoqe, ai s'ka dalë jashtë shtetit, po diku këtu rrotull duhet të jetë.

— Ju lutem, shokë, më lini të punoj.

Kur të thotë tjetri më lini të punoj, do të thotë të mos e pengosh në realizimin e detyrave të tij, se e lë pa punë, pavarësisht se kujt i shërben ajo punë.

Dualëm në hyrje dhe po mendoheshim. Tani më ra ndër mend t'i hidhja një sy lokalit. Vetëtinte nga pastërtia. I larë e i lyer për merak. Po ç'e do! Vëtëm kaq. Të qe dhe shërbimi në këtë shkallë!

— Me vrap pas meje! — thirri Suloja dhe u nis, ndërsa unë, që s'mora vesh se për ku u nis, po e kundroja shokun tim, që vraponte si një klloun çirku. U nisa pas tij.

— Shkele pak gazin! — bëri shaka. Unë nxitova këmbët derisa u gjendëm në një restorant tjetër. Në banak na pritenjë meso grua dhe një burrë; nga veshja burri dukej kuzhinier.

— Këtij shokut kuzhinier nuk i ka dalë viza për jashtë! — më tha Suloja nën zë.

— Ju lutem, a keni për të ngrënë?

— Gjithë të mirat! — na ngrohu kuzhinieri. — Kemi biftekë, bërxolla, shish, gjoks qengji, qengj të pjekur... Mua m'u mbush goja, stomaku, i lajmëruar nga veshët dhe hunda, e hapi thesin, që të prishte ngarkesën e re.

— Unë dua biftek, bërxhollë dhe qengj të pjekur! — porositi Suloja.

— Unë po ato dua!

— Më parë duhet të faturoni.

— Menjëherë! — thashë unë, duke u kthyer nga kabina e arkëtares, por ajo qe bosh. Kuzhinieri qe-



shi, zorrët e mia kuisnin.

— Ka dalë pak, se i dhimbte koka! — Mua m'u
prenë gjunjët.

— A i dhimbte shumë koka?

— Shok, mos u tallni me fatkeqësinë e tjetrit!
— na qortoi kuzhinieri.

— Po ju pse talleni me shërbimin ndaj klientëve? — pyeti Suloja.

Meqë nuk na u përgjigj njeri, Suloja tha:

— Me vrap pas meje! Si vrapuam nja dyqind metra, u gjendëm para një rosticerie tjetër, dera e së cilës qe mbyllur. Në një copë pusullë lexohej: Kemi mbledhje». Ne e lexuam dhe psherëtimë.

— Me vrap pas meje! — Këmbët e Sulos paske-shin qenë më të forta nga gomat e makinës. Vrapuam edhe treqind metra dhe u gjendëm para një rosticerie tjetër, në derën e së cilës mënjanuam një karri-ge bosh dhe u futëm brenda.

— Ku veni ju? — na pyeti rreptë një grua me një fshesë të gjatë në dorë.

— Duam të hamë!

— Nuk e shihni se po bëjmë pastrimin, apo s'e patë karrigen?

Duallëm te dera dhe lexuam orarin. Lokali don-te edhe një orë të mbyllej.

— Moj shoqe, në orar të punës...

Më s'munda ta vazhdoj fjalën time, sepse kamarierja ma mbylli derën nga brenda, jo me karrige po me shul metalik.

— Me vrap pas meje! — Suloja u nis përsëri. Pas tij edhe unë.

— Bëj durim, vëlla, se rrugën e kemi pak të gjatë!

— Sa? — pyeta unë.

— Nja pesëqind metra! — u përgjigj ai.

— Deri ku?

— Në «Turizëm»!

Shiritin e restorantit të «Turizmit» e preu gjok-

si i Sulos. Vendin e dytë e zura vetë me një minutë e 48 sekonda më vonë nga Suloja.

— Shoqe! — munda të thërras sa zura vend në karrige.

— Shshttt! — ma bëri Suloja — Ky është lokal serioz, me shërbim të superkultuurar. Heshta. Kamarierja, si mbaroi bisedën me kuzhinierin, mori një laps dhe filloi ta mprehë më nge. Mua gati po më binte të fikët, ndërsa Suloja rrinte serioz, ash-tu siç e kërkonte vetë një lokal serioz.

Mirëpo kamarierja na paskej edhe dy lapsa të tjerë për të mprehur. Si e kreu edhe këtë punë, na solli menynë. Suloja e mori dhe po e lexonte me zë: supë magjaric... peshk me limon... stomaku im u bë grusht. Torturë e vërtetë. Kur më kujtoi pesh-kun me limon, unë nuk munda më, por u këputa dhe rashë sa gjerë gjatë në qilimat e lokalit. Suloja, duke dhënë alarmin, më përfshiu në krahët e tij muskulozë dhe më uli prapë në karrige. Sa ishin aty lanë lugët dhe ç'patën në dorë.

— C'pati?

— C'e gjeti?

— I shkreti!

— Nga se vuante?

— A ka qenë burrë i mirë?

— Ish pa ngrënë — tha Suloja me pikëllim.

— Si ka mundësi? Tek ne pa ngrënë? Kur në çdo tridhjetë metra dy nga dy rosticeri, bufe, by-rektore, piteri e restorante?

— Hapuni! Po vjen mjeku. Unë nuk mund të hapja gojë. Dhe me të vërtetë doktori, i ndodhur aty, erdhi pranë meje. Në fillim vuri dorën në zemër dhe, si u sigurua, e zbritti dorën më poshtë në

stomak. Dora topolake e mjekut u fundos deri sa takoi kolonën vertebrale:

— Urgjent në spital! — urdhëroi mjeku. Pa mbaruar fjalën mjeku, unë hapa sytë dhe thashë.

— Jo në spital, po në kuzhinë!

— Qenka gjallë, po i lajthitur. E ç'do ky në kuzhinë? — pyeti mjekun kamarierja.

— Dua supë magjarice, peshk me limon dhe pa limon, ngjala, pastiço, pilaf, biftekë, bërxxolla dhe ç'të kini tjetër.

Në lokal plasën të qeshurat. Edhe unë doja të qeshja. Në çast tavolina jonë u mbush me gjithë të mirat dhe ne e kthyem situatën në një festë të vogël, por të gëzuar.

SA KUSHTON NJË SHTËPI?

Aq e kaq, do të thoni ju. Asnjë qindarkë! do të ngul këmbë unë.

Dhe ja pse.

Kur pashë se pranë truallit tim u shkarkuan me dhjetëra makina me gurë, unë hapa themelet, të cilat i mbusha brenda natës me gurët e rrugës. Në fund të fundit ç'bëra? «Shkula pesë qime nga koka?» Mendoj se pesë qime nuk ngrenë kandar për një ndërmarrje ndërtimi që qarkullon me miliona metro kub gurë, apo jo? Tani radhën e kishte tulla. Për këtë më ndihmoi bicikleta ime, e cila ka ardhur me një kosh të madh në formë zgare nga fabrika. Pra i hipja bicikletës dhe dilja, si i thonë, për gjah. Kur gjeja ndonjë tullë në rrugë (dhe zaten disa nga ndërmarrjet tona mbjellin lloj-lloj materialesh rrugës), e merrja dhe e vija në kosh. Në fund të fundit ç'bëra? Mora një tullë, që kishte në mos një vit, të paktën gjashtë muaj e harruar. E para, tulla do të shkonte dëm dhe e dyta tulla mbetet armë e ftohtë. Po sikur në mos dy fëmijë, dy të rritur të ziheshin e t'ia shkarkonin këtë tullë njëri-tjetrit në kokë? Pra mbrojta pasurinë e përbashkët nga një anë dhe, nga ana tjeter, parandalova një krim të mundshëm.

Koshi i bicikletës merrte dhjetë tulla. Ngarko-



hesha së paku tri herë në ditë, po sa ditë ka viti? Me një fjalë, muret u ngritën. Harrova t'u them se mua më zë dora çdo gjë. Jo vetëm që jam punëtor i palodhur, por edhe me shumë zanate, për këtë mund të bindeni po të shkoni në ndërmarrjen ku punoj. Fotografia ime qëndron në tabelën e nderit me

«ekran të gjerë». Tani më duheshin dërrasa, nga të cilat tek ne gjen plot, qoftë të hedhura andej-këtej depove, qoftë edhe si arka makinerish. Dhe në qoftë se do të më shikonte ndokush me një dërrasë nën sphetull kur kthehesha nga puna, do të thoshte: «E mo, ç'bëri, një dërrasë mori, s'u bë kijameti! Gjetiu kalben me ton, ose, ose digjen për dru. Kështu dërrasë pas dërrase i rregullova të gjitha dërrasat dhe çatinë e përfundova. Tani, meqenëse dhe tjegullat i mbloida ashtu si tullat, çatia përfundoi komplet...

Me siguri ti po qëndron me kalem në dorë se mos kam paguar ndonjë qindarkë. Gabim e ke. Të paktën gjer tanë nuk kam nxjerrë asnjë kacidhe nga xhepi. Dhe pse të nxjerr? Kur kam mundësi të ndërtoj një shtëpi pa para, pse ta ndërtoj me lekë, apo jo?

Së fundi, le të hapim letrat. Çuditem dhe nuk kuptoju shumë gjëra. Për shembull, përsë tullën ta marr nga rruga dhe ta bie në shtëpi dhe përsë të mos ta çoj në ndërmarrje? Mos vallë ngaqë kërraba heq nga vetja?...

Tani, i dashur lexpus, u binde për atë që të thashë në fillim.

Para se të ndahemi dua të të sqaroj se autori i këtyre rreshtave jeton në apartament, në katin e pestë, dhe me gjithë sa tregoi bëri vetëm një «shaka»! Por, ama, mos harro se ka ndonjë që nuk bën shaka në këto gjëra. Po ama edhe ne nuk duhet të bëjmë as «shaka» dhe as sehir me këta keqbërës, sadopak që të jenë.

TE PIMË NJË KAFE...

- Hajt të pimë një kafe — më lutej një shok.
- Kafe pimë, po jo në këtë lokalin këtu — i thashë.
- Përse?! Ky është lokal i mirë që kemi ne.
- Është.
- Apo s'ka një banakiere që ta bën kafen me ajkë!
- Ka.
- Mos pyet për kolltuqet që humbet në ta kur ulesh.
- Humbet.
- Lëri pastaj sistemin e ventilimit, që s'e gjen as në Tiranë.
- Nuk e gjen.
- Po pikturnat?!
- Pikturat! — shoku më kish kapur nga krahu dhe po më drejtonte në hyrje të kafenesë.
- Ku më çon? — ndala këmbët unë.
- Të pimë kafe.
- Jo, jo, nuk mundem.
- S'ke kohë?
- Kam.
- S'ke para, kam unë.

- Kam.
 - E po ç'ke që nuk vjen të pish kafe?
 - Kam frikë...
 - Ke frikë, nga kush? Unë nuk po të çoj në litar.
 - Kam frikë nga kamarierja.
 - Nga kamarierja?!!! Pse, bishë kanë vënë mariere, apo një panterë?
 - Nuk e di, po atje nuk guxon njeri të pijë kafe.
 - Pérralla! Ec me mua.
 - Ti nuk je shef i saj. Po të qe, do të vija vetë, kështu mos më merr më qafë.
- Shoku im gati më hoqi zvarrë dhe më uli në një kolltuk. Kamarierja, një nuse kaq e bukur sa edhe i vdekuri do ta nxirre kokën nga varri për ta parë, po lexonte s'di çfarë libri. Ajo as e kthjelloi, as e turbulloi, kur thonë.
- Nga kjo ke frikë ti? — pyeti shoku nën zë.
 - Kjo është më duket.
 - Kjo qenka bukuria vetë!... — bëri shaka shoku.

Kaluan dhjetë minuta në lokalini bosh dhe kamarierja vazhdonte leximin. Shoku im, që nuk i qe përvëluar ndonjëherë lëkura, i thirri:

- Shoqe! Jemi edhe ne këtu. Ka shërbim apo jo?
- Mbushu një herë me frymë, a derëzi, pastaj.
- S'kthehem nga maratona, — mbreu qetë shoku im, — prandaj ec e na merr porosinë. — Kamarierja ktheu faqen tjetër të librit.
- Më mirë shkojmë në ndonjë vend tjetër! — i lutem shokut, po ai nguli këmbë të pinim kafe aty.
- Shoqe, po presim ne.
- Bravo të goftë në pret, po s'prite, ja dera!

— Ju, shoqe, nuk e kryeni detyrën në rregull...

— Më mirë shiko veten ti si e kryen. Pse, nuk të njoh unë ty? Me rrënje e dhëmballë. Pa le, më vjen e më shet mend! Shiko veten, që në orar të punës vjen edhe pi kafe.

— Ku e di ti që jam në orar të punës? Unë jam me leje...

— Kështu thonë shumë si ti, po vërdallosen klu-beve gjithë ditën, sikur nuk kanë shtëpi... — Ndërsa unë tendosa muskujt, si në startin e njëqindmë-tërshit, për t'ia dhënë vravit, shoku im e humbi du-rimin:

— Ju, shoqe, nuk jeni në rregull me detyrën. Po ajo nuk e la të vazhdonte më tej.

— Kujt i thua ti që s'je në rregull? Ti s'je në terezi! Ti, që s'di gjë tjetër vetëm të zihesh me gratë e botës. Gjer këtu unë arrita të rezistoj heroikisht, më tej nuk munda më. Por shoku im qe ngritur para meje.

— Pate të drejtë. Eja dalim, se këtu veç kafes mund të pimë edhe fyerje të tjera të paporositura!

— tha ai.

Dolëm qetë-qetë. Nga pas u ndie zëri i kamari-erës: «Prapa diellit!».

BALLË PËR BALLË

Ishim në një dasmë dhe, kur po prisnim që të buçiste kënga, plasi një debat që vazhdoi të paktën një orë. Këtë e hapi një plak në qoshe.

— Të të trashëgohet djali, o i zoti i shtëpisë, gëzofsh edhe nga të tjerët!

— Gëzofsh edhe ti nga barku yt! — priti urimin i zoti i shtëpisë.

— Jo, kështu s'para më pëlqen mua, — vazhdoi plaku. — Kjo s'është martesë me lezet. Nuk kanë qenë budallenj të parët, që fejoheshin dhe martoreshin me mblesëri.

Lajmësi u krekos, mori gotën e rakisë dhe iu drejtua plakut të qoshesë.

— Të paça, o xha Kozi! Jo, po mbushu mendjen disave, që i marrin gratë me dashuri të dielën dhe i ndajnë të hënën.

— Emo, dashurička! Kur lëpihen u duket e èmbël, por pastaj...

— Të rintjtë kaq deshën dhe muarën flakë:

— Xha Kozi! Kam shumë respekt për të moshuarit, por ama për mendimet e tyre të mykura, më fal, unë nuk mund të qëndroj indiferent. Dasmorët tanimë u ndanë në dy grupe. Me një fjalë luftonte e reja me të vjetrën, hapur në një dhomë dasme, ba-



llë pér ballë. Me tē rintjtë qenë bashkuar edhe tē moshuar, ashtu, siç kish edhe ndonjë tē ri në anën e pleqve.

— Mos, — tha plaku, — se pér nder që ka burri do t'u nxjerr tē palarat në shesh.

— Ne nuk trembemi nga tē metat.

— Ashtu, è?! — plaku rrudhi sytë e tij, po-thuajse pa qerpikë.

- Fol hapur! Nuk kemi gjë të fshehur.
 — Gjërat e fshehura i bëni nëpër ferra ju! —
 u hodh një plak tjetër dhe qeshi gjersa e zuri kolla.
 — Mund të ketë edhe ndonjë që fshihet nga
 gojët e këqija.
 — Mos e zgjat më, se kam disa fakte unë...
 — Nxirri! — u hodhën disa në një gojë.
 — Janë shokët tuaj...
 — Ore fol, ç'ke pér të thënë? Ne nuk kemi fri-
 kë.
 — Mirë atëherë, po ju pyes. Nuk u martuan me
 dashuri Vasili me Ervehenë dhe pas një javë kërkua-
 n të ndaheshin në gjykatë, paçka se e përdrodhën ata
 shokët e gjykatës dhe i bashkuan përsëri?...
 Ndërsa debati u ndez më shumë, mua më shkoi
 mendja tek çifti i të rinjve. Grindjen e tyre e mora
 vesh atë ditë... Po e nis nga e para.
 ... Dera trokiti si mëdyshas dhe në të u fut
 një djalë i ri rrëth të njëzetave. Si u përshëndetëm
 e pyeta pérse kishte ardhur. I riu si me turp foli:
 — Pér ndarje.
 — Si, i martuar qenke ti? — u çudita.
 — Po! — mundi të thotë ai.
 — Sa kohë po bën që je martuar?
 — Kam, kam... Kam nja dy javë...
 — Dy javë! Si kështu?! Mos ju kanë martuar me
 mblesëri?
 — Jo.
 — Si quhesh?
 — Vasil.
 — Po bashkëshortja?
 — Ervehe.
 — Mirë, po nuk më thua, pérse doni të ndaheni
 kaq shpejt?

— Grindemët

— Po mirë, nuk keni mundësi të pajtoheni? — e pyeta me shpresë.

— Më ka luajtur eshtrat e gjyshit! — tha me ner-vozizëm.

— Ç'ka bërë, ç'ka bërë?!?

— S'më ka lënë gjë pa fyter, që nga gjyshi, gjer tek unë.

— Mirë me ty bashkëjetonte, po gjyshin ku e gjeti që e fyeu? Me sa e di unë ti nuk e ke arritur atë...

— Edhe në qoftë se nuk e kam arritur, nuk do të thotë se ai s'është gjyshi im. — I thashë të afro-hej dhe ai nisi të më tregojë për grindjen e vetme dhe «fatale» që i çoi gjer në shkurorëzim. Ja se si qëndronin punët:

Kur i kërkoi Vasili një gotë ujë, Erveheja u ndodh duke larë dyshemenë.

— Merre pak vetë, se...

— Çfarë the? — Sedra e burrit, që ndonjëherë i ngjan ngulmimit të mushkës, u plagos keqas.

— Më jep ujë, të thashë! — i bërtiti ai dhe shikoi nga eëma, që s'dihet pse përdrodrohi buzët.

— Mos bërtit, se nuk ka lezet. Unë veshët në vend i kam.

— Veshët në vend i ke po mendja të ka fluturuar.

— Të kam ty të mençur! — i tha Erveheja si me shaka, duke i dhënë gotën me ujë. Ai e mori dhe ia flaku te këmbët.

— Kot nuk më thanë se ti je një piperkë djegëse sa edhe në fshat mos të pastë njeri!

Tani edhe Erveheja e humbi durimin.

— Në qoftë se e dije si isha, pse më more?

— Unë të mora, unë të i le prape e të çoj te jet emë.

— Nënën mos e zër në gojë, se nuk të ka ndonjë faj!

— E bija e asaj je ti...

Kështu grindja mori përpjetë nga prindërit te gjyshrit e stërgjyshërit, përfshiu edhe farefis, gjersa arriti edhe te fshatrat e njëri-tjetrit...

Tani, me gjithëse Vasili me Ervehenë janë pajtuar me kohë, kanë edhe dy kolopuçer plot shëndet, fanatikët e fshatit i mbanin si fakte «të forta» përtë treguar se martesa me dashuri nuk qëndroka...

Po le të kthehemë te dasmorët.

— Copë po ta them, se ti, xha Trushi, në vend që të këshilloje Vasilin, i vure mizat, bile i the se gjyshi i saj, po ashtu grindavec na paskej qenë, — i tha një i ri plakut që ishte thyer plotësisht.

— Pse ma merrni përters, more djem, unë një fjalë thashë dhe ju e bëtë tërkuzë.

— Një lugë kos do dhe kazani me qumësht që të mpikset kos i téri! Plaku s'foli më.

— Pse ti, xha Kozi, nuk je zënë ndonjëherë me plakën, kur keni qenë të rinj? — pyeti një djalosh që shërbente në këmbë te dera.

— Kurrë! — tha plaku.

— S'na besohet! — foli përsëri ai që shërbente.

— Pyesni fqinjët, moshatarët e mi.

— Ku do ta merrnin vesh ata?

— Atje ku i marrim vesh ne hyneret tuaja.

— Ne i kemi hapur gjërat.

— Po ne kush na i mbante mbyllur nga veshi i botës?

— Druri, kërciste druri si në Karadak.

— Pyesni plakën! — tha xha Kozi, i zënë ngushtë.

Dhe ja, plaka e xha Kozit, sikur të qe porositor, u dha tek dera.

— Nëno, — iu drejtua njëri, — si ka qenë xha Kozi në të ri?

— Balli i djemve të fshatit! — tha plaka me mburrje.

— Ne të pyesim për të tjerat, se na thotë që ka qenë i urtë!

Plaka iu kthyte të shoqit.

— I urtë ti, more?! Po ti e mbaje dorën në kobure dhe brezin zvarrë kush të ta shkelte!. — Të gjithë qeshën. Plaka e xha Kozit, duke marrë zemër edhe nga dasmorët vazhdoi:

— Pa le si më thoshte, kur unë i qahesha: «Hajt, ik tutje, se gruan nga të rrashurit dhe nga të pjellët nuk e gjen gjë.»

Xha Kozit iu varën mustaqet, ndërsa dasmorët morën një këngë të re përmartesat e reja.

KUR MË ZURI SEVDAJA

Edhe mua, si shumë të tjerë, një ditë më zuri sevdaja. Vajza që desha quhej Ezmeralda. Ajo pунонте tek ne, ndërsa prindët i kishte në një fshat të Tiranës. Nga kashta s'kishte asnë të sharë. Ndënjë pëllëmbë më e shkurtër se unë, sy, vetull e flokë katran, pak zeshkane, e dashur, e qeshur, nzelleshë. Ishte pikërisht kashta që m'i zuri sytë e nuk pashë më tutje.

Ne i dhamë fjalën njëri-tjetrit dhe s'vonoi shumë e një ditë ma preu rrugën një mesoburrë me një kapele me strehë në kokë.

— Më falni, ju jeni Konstandin Fusha? — më pyeti.

Qëndrova përpara atij burri me xhaketë të zëzë, në jakën e së cilës kishte vendosur një koleksion dinistikтивash, ndërsa në xhepin e anës mbante të palosur një gazetë të ditës.

— Po, — i thashë,

— Gëzohem, — ma ktheu dhe më shtrëngoi dorën me tërë fuqinë. — Jam babai i Ezmeraldës.

— Gëzohem, — i thashë edhe unë i hutuar, por ai nuk më la ta mblidhja veten. Më vuri krahun dhe më futi në një kafe aty afër. Për një çast mbetëm memecë. Pastaj, ai, si férkoi njëherë duart, foli:

— Besoj se s'bëra gabimi që të ndala, biri im.
— Aspak. Përkundrazi...

— Ashtu, më rrofsh! Ti s'e kupton dot mirë tani që çdo prind shqetësohet për fëmijët e tij. Dhe ka të drejtë. Sepse ato që kemi hequr ne nuk numërohen, pa le ato të luftës.

Ai tundi kokën mendueshëm, sikur gjysmat e vuajtjeve të luftës t'i kishte mbajtur mbi supe.

Si vumë përpara gotat e konjakut, ai uroi:

— Epo të trashëgoheni, bijtë e mi!

«Si shumë ia shkeli ky, — mendova unë —
...Oj, si qenka kjo punë? Ende pa u njojur me të
dhe vete e uron...»

Shkundi gotën e mori kafenë. Si e rrufiti nja dy herë, pyeti:

— Punon krushku, apo është në pension?

— Jo, në pension.

Përzemërsia e tij, edhe e parakohshme edhe si e shtirur, nuk para më pëlqeu. Kishte diçka që nuk vinte në këtë mes, por unë nuk po e kapja dot. Se s'isha marrë ndonjëherë me këto punë.

— Sa mirë, sa mirë! Qëlluam të dy familje të mira. Do të merremi vesh. Për nder, kjo më shqetësonte. Se janë gjëra me rëndësi këto, o djali.

E ç'ta zgjat! Më foli nja dy orë për familjen, për fisin, sojin e sërën. Pastaj, papritur, më pyeti:

— Po bufenë kur do ta bëjmë?

— Bufenë?! — u zura ngushtë unë. U zura ngushtë se këtij muhabeti nuk i kishte ardhur radha as me Ezmeraldën e jo më me të atin. — Po ja, të bisedoj njëherë me babanë.

— Ashtu? Më rrofsh, o bir! Asgjë mos bëj pa pyetur prindët. Këtu duket njeriu me edukatë familjare dhe me prindër të denjë.

Nuk e zgjata. Qysh atë natë i thashë babait. «Shohim e bëjmë — ma ktheu ai dhe nisi të më pyeste gjatë e gjerë për Ezmeraldën dhe familjen e saj. Një ditë u mblozhëm në klub për të pirë rakinë e parë, sa për t'u njojur. Delegacionin e krushqisë nga ana jonë e kryesonte babai. Pas tij vinin vëllai i madh, kushëriri i parë dhe unë. Delegacionin e nuses e kryesonte babai i Ezmeraldës, pastaj edhe nja dy burra të tjerë. U ulëm ballë për ballë duke qarkuar në mes tavolinën.

Unë i mbaja sytë te im atë. Ai hoqi syzet që përdor për lexim, vuri të tjerat për të parë larg dhe ia drejtoi babait të nuses sime. Tjetri uli sytë e rrudhi vetullat. Në këtë kohë u ngrit vëllai im dhe bëri paraqitjen e anës sonë. Krushqia e nuses, me dorën në zemër, bënte urimet e rastit.

Deri këtu puna vajti fare mirë. Po kur filloi paraqitja e anës tjetër të krushqisë, atëherë puna u mahis keq. Sapo dëgjoi emrin e babait të Ezmeraldës, Bexhet Zvergu, tim eti i ra cigarja nga dora. Tjetri u mundua të buzëqeshte.

— Ky këtu, — vazhdoi paraqitësi, — është dajojë i nuses, Sherif Qebapi, kurse unë jam kunati i Bexhetit dhe quhem Nazif Keçka.

Babai m'i nguli sytë egër dhe e thithi cigaren me forcë.

— Kamerier, — thirri njëri nga pala e nuses.

Babai nxori dorën përpara, sikur donte të ndalonte ndonjë makinë, e i tha:

— Pa dale të njihemi njëherë. Jemi ne zot shtëpie këtu.

— Duke pirë e duke u njojur, o krushk, të pacë! — qeshi babai i Ezmeraldës, ndërsa dora e babait tim nuk ishte ulur akoma.

Mua sikur më ra pika dhe mbeta si hu gardhi. Plakosi përsëri heshtja, sikur mbi tavolinë të ishte shtrirë xhenazeja e jo çështja fejesës... Ç'të bëja! Nxora paketën e cigareve dhe e zgjata nga krushqit e nuses. Babai i Ezmeraldës ma mbajti dorën.

— Jo, biri im, nuk bën të shkëmbejmë duhanin më parë. Se kjo ndjell keq. Të hamë llokumet njëherë. Të ëmbëlsohemi. Apo jo, more krushk? — iu drejtua babait tim, pastaj kamerierit: — Llokumet!

Kamerieri, i cili, siç duket, porosinë e kishte gati, u gjend pranë nesh.

— Prit! — thirri im atë, aq sa kamerierit desh i ra tabakaja nga dora. Të gjithë prenë frymën.

— Më njeh apo s'më njeh, more Bexhet Zverku? Apo bën sikur s'më ke parë kurrë? — iu drejtua im atë babait të Ezmeraldës.

— Jo, krushk, hera e parë që të shoh. Ç'është kjo pyetje?!... Mos më ngatërron me ndonjë tjetër...

— Mos u nxito të më thërrasësh krushk, — u nxeh më keq im atë.

Të gjithëve sa qenë aty u duk sikur u ra tavani mbi kokë; kurse mua tavani me gjithë çati.

— Nga Zverku je ti, ë? — uli zërin babai im. Tjetri sikur u drodh e u përmblodh brenda xhaketës së tij.

— Po.

— Ku ishe në janar të dyzet e katrës? Për shkarpa apo në dasmë?

— T'i lëmë të kaluarat! — i erdhi në ndihmë i kunati Bexhetit.

— Çfarë?! — mori zjarr babai. — Kush e ka thënë këtë xhevahir? Ta dimë dhe ne! Pa m'u përgjigj, o Bexhet, ku ishe?

- Në fshat! — mundi të thotë Bexheti.
- Në fshat, ë?! Po ç'hyjnere bëje aty?
- Po ja, me bujqësi jam marrë.

Bexhetit s'i kishte mbetur pikë gjaku në fytarë.

— Me bujqësi, ë?... Mos ke lëruar ugaret e italianëve e të gjermanëve me shokët e tu ballistë?...

— Krushk.

— C'është ajo krushqi, more?

— Dua të them shoku...

— Ti shok me mua? — ia preu fjalën përsëri im atë.

— Jo... po... desha të thosha se këto janë të kaluara e të...

— e të harruara, mos doje të thoshe?

Babai tundi kokën e u ngrit në këmbë.

— Mos dëshiron zotrote që të harroj Vangjelin, partizanin e plagosur, që ti e spiunove te gjermanët? Dhe, po të mos kish nxituar çeta jonë, atë do ta kishin vrarë.

— Të lutem, atë s'ke përse ma kujton. Unë e shleva me dënimin që mora. Pastaj fëmijët e kanë gjetur vetë fjalën me njëri-tjetrin.

Babai hodhi vështrimin nga unë. Unë u ngrita në këmbë.

— Ke gjetur gjë ti, more djalë? — më pyeti ai dhe me inat po edhe me ironi.

— Jo, baba, këto gjëra nuk m'i kanë treguar.

Ndërkohë kamerieri e kishte vënë mbi tavolinë tabakanë plot llokume. Babai u ngrit qetë-qetë dhe u tha atyre të palës tjetër:

— Hani dhe u bëftë mirë! — pastaj dolëm së bashku, duke ua lënë llokumet në duar atyre të palës tjetër.

TRI DITËT E PARA TË DREJTORLLËKUT

DITA E PARË

Kjo puna e drejtorllékut paska qenë me të vërtetë me telashe. Më e udhës është që ta tregoj se si u bëra drejtor.

Më parë se të bëhesha (ose më saktë se të më bënин) drejtor, isha mekanik në ndërmarrje, vazhdoja edhe filialin për inxhinier mekanik. Drejtorin tonë e transferuan në Tiranë, po drejtor ndërmarrjeje, megjithëse ky transferim... Po nejse do ta marrim vesh më vonë atë punë...

Pas dy ditësh u mblohdh kolektivi i ndërmarrjes për të zgjedhur vetë drejtorin. S'mbaj mend kush u ngrit e më propozoi mua. Kaq u desh që unë të gjendesha në karrigen e drejtorit, pa ditur as vetë se çfarë duhej të bëja e nga t'ia filloja. Në këtë kohë ra zilja e telefonit. Ngrita receptorin dhe iu përgjigja:

— Alo, urdhëro!

— Kush je? — pyeti bashkëbiseduesi.

— Konstandini jam.

— Drejtorin dua, ka mundësi që të flas pak me të në telefon? Aty për aty harrova se unë isha drejtori dhe u ngrita ta kërkoja, po pastaj e mblo-dha shpejt veten.

— Drejtori jam! — i thashë duke u skuqur.

— Si kështu?! Ju jeni drejtori, po shoku Selam ku shkoi?

— Në Tiranë.

— Ah qerratai, më në fund i gjeti çelësat, po nejse, shoku Konstantin, meqë m'u dha mundësia, më lejoni t'ju uroj nga zemra për detyrën e re. Urime, sinqerisht, më bëhet qejfi, po si e keni mbiemrin ju?

— Fusha.

— Ah, e bukur shumë Fusha, për nder s'ka mbiemër më të bukur...

Ndërsa bashkëbiseduesi vazhdonte të më lëvdon-te mbiemrin, unë rrija e dëgjoja si guak gjersa ai më përmendi.

— Alo, alo, më dëgjon apo jo?

— Të dëgjoj, të dëgjoj!

— Hë po, më falmi se nuk u paraqita: Jam drejtor i uzinës rajonale dhe kemi rënë dakord me shokun Selam (...eh, rrufjani!) pra me shokun Selam jemi marrë vesh për ca pjesë këmbimi që më duhen mua, kurse unë do t'ju jap dhjetë ton çimento pesëqindëshe... je dakord apo jo?

— Po ne s'kemi nevojë për çimento!

— Eh, duket që nuk ua ke marrë dorën këtyre punëve. S'të duhet sot. Po mot? Po pas dy vjetësh? Do të zgjeroheni, do të rregulloheni. Fundja e mbanë sa ta mbani, pastaj gjejmë ku ta degdisim. Unë për të mirën tuaj e kam, pa çimenton ta fshijnë nga dora.

— Ç'të them unë...

— E a derëbardhë me shkëmbim i kemi, më jep të jap, noga shteti në shtet do të shkojë, se mos do t'i çojmë në shtëpi!...

— Nuk mundem, se nuk i njoh mirë këto punë.
Sa të bëj ndonjë shkelje...

— Ç'shelje, a derëbardhë..., po më duket se paske frikë ti... — Zëri heshti, pastaj rënroi: — Eh! Ku je, more Selam rrufjani!... — përsëri më pyeti: — E, ç'thua?

— Nuk mundem!

— Faleminderit dhe dëgjo, kështu si e ke nisur as pesë ditë nuk e mban karrigen e drejtorit ti. Hapt, zoti të dhëntë shëndenë, se mendtë i paske të holla fort... Në kufje u ndie zhurma e përplasjes së receptorit të kolegut bashkëbisedues dhe çdo gjë heshti.

Edhe unë, nga ana ime, e përplasa receptorin e telefonit në vendin e vet, duke u dhënë të drejtë disa drejtorëve që e nxirrin inatin e tyre tek telefoni, sepse, ç'është e vërteta, ai drejtori i rajonales më futi mizat aq sa të merrja telefonin e t'ia hidhja në kokë atje në zyrë ku ishte. Kuptohet se këtë gjë nuk mund ta bëja. Vetëm mora kokën midis dy duarve me shikimin nga xhami i tavolinës së punës.

Më tërroqi vëmendjen një copë letër e palosur. Ngrita xhamin dhe e mora. Si e hapa, lexova:

«*I dashur Selam!*

Letërprurësi është kunati im. Të lutem merre në punë, se është zanatçi i mirë. Në ndërmarrjen ku është i nxuarën ca ngatërresa kot së koti. Kushuririt tënd i rregulluam nja 6 000 lekë shpërblim dhe e nisëm në plazh me kabinë. Para tri ditësh të kam dërguar nja pesë kile qefull, që m'i pruri një mik nga Karavastaja.

*Të përqafoj:
Yti Selimi!»*

Kjo pusullë më shtoi kureshtjen, prandaj nxora të gjitha letrat e palosura nga xhami dhe nisa t'i lexoja.

«*Shoku Selam!*

Jam e qofsh mirë! Shoferi i makinës që më dërgove ishte me të vërtetë çapkën i madh. Për gjithë natën mbajti zhavor e rërë sa të ndërtoja dy shtëpi dhe jo një. Po ama edhe unë ia shpërbleva mirë, i mbusha makinën me dërrasa pishe pa një kokërr leku, se i kishte mbetur shtëpia pa shtruar, të shkretit.

Duke përfunduar të porosis *Selam*: Ruaje atë shofer se do të na duhet përsëri. Me letërprurësin po të dërgoj nja tre kile mjaltë.

Hajt, mjaltë e sheqer shoqëria jonë

*Të puth e të përqafoj:
Tofiku».*

Meqenëse oreksi ndjell oreksin hapa letrën tjetër.

«*Vëlla Selam!*

Të falënderoj nga zemra për të mirën që më bëre, se im kushëri, po t'i biesh drejt, nuk meriton as kategorinë e tretë e jo të pestën që i rregulluat ju. Nesër mbrëma ju ftojmë në shtëpinë e tij, mbasi ka «thyer» këmbën një qengj?!!!!

*Të përqafoj e të pres
I juaji Stefani».*

Letra të tjera kishte plot, që edhe sot e kësaj dite nuk e motivoj dot se përse i ruante ato Selimi. Nuk do t'i citoj të gjitha se do të mërzitet lexuesi im i dashur vetëm, me lejen e tij, po lexoj edhe një. Letra ishte pak e gjatë.

«I shtrenjti Selam!

Jam shumë keq. Po e them qysh në fillim, se nuk është shaka të martosh djalin. Të gjitha gjërat i kam rregulluar, vetëm puna e veturave që të shkojnë krushqit në Korçë për të marrë nusen, sikur po më dështon. Prandaj, të lutem, dua pak «Varshavën» tënde gjer në Korçë. Besoj se tri vutura, e imja e jotja, dhe e drejtorit të rajonales janë boll. Për atë ditë ju emëroheni krushku i parë.

Unë me drejtorin e rajonales do të shkojmë me «shërbim» në uzinën e precizionit për ca detaje. Kështu që edhe ti «dridhe» në ndonjë ndërmarrje tjetër.

Në dasmë do të vijë edhe shoku X.Y. nga ministria. Atje mund të bisedosh edhe për punën e transferimit (të doli xhani për atë të shkretë Tiranë). Po fundja mirë u bë, se u kalbe njëzet vjet aty.

Edhe një herë të lutem mos harro për «Varshavën», se po më luan tepeleku i kokës.

Ta shpërblesha në dasmë të djalit.

*Përqafime e nderime
Faiku».*

«Oj, — mendova — kaq lehtë u dhënka «Varshava» këtu?»

Pa mbaruar mirë letrën e Faikut trokiti dera dhe nga ajo u fut shoferi i «Varshavës» sonë.

— Mirëmëngjes shoku drejtor! — përshëndeti ai.
— Mirëmëngjes, ç'kemi?
— Erdha të uroj shokun drejtor për detyrën e re.
— Faleminderit!
— Erdha, gjithashtu, t'ju pyes se në ç'orë e
pini kafenë.

— Kafenë? — u habita unë. — Nuk pi kafe fare.
— Ashtu?! — u çudit ai këtë herë... — e po më
falni... unë këtu jam... mirë u pafshim!

Shoferi doli duke mbyllur derën me kujdes.

M'u zu fryma në karrigen e drejtorit. Vendosa
të shkoj në repartin tim, në repartin mekanik, kur
zilja e telefonit më gozhdoi përsëri në karrige.

— Alo!

— Urdhëro!

— Drejtori?

— Po, ai jam.

— Urime, shoku drejtor. Ju jeni i mrekullue-
shëm. Të betohem se mbas pesë vjetësh ju do të
bëheni zëvendësministër, në mos më lart... Dëgjo,
jam Halimi. Jemi gjak, o rrufjan; po ti tani u bëre
drejtor dhe do ta bësh gjakun ujë...

— Më falni, cili Halim jeni ju?

— Halimi i Zaçes... nuk më njeh?

— Vrava mendjen për këtë Halimin e Zaçes, po
asgjë s'm'u kujtua, bile as në hatër s'më binte fare...
As Zaçja e as Halimi.

— Nuk më kujtohesh! —i thashë.

— Si ore, nuk të kujtohem, po unë të kam rrri-
tur në prehër e më ke shkulur mustaqet, pa le një
herë më ke bërë edhe ujët në qafë, mender zotrisë
sate, po ama... dukeshe, firaun, që do të bëheshe i
madh! Ja, më kujtohet si sot, kur mblidhje kalamajtë

e lagjes dhe i bëje «sus»...; nejse nejse, po ti më paske harruar... nejse, nejse do të vij në shtëpi unë.

— Të urdhërosh! — i thashë automatikisht — mirë u pafshim!

— Mirë u pafshim, trimi i xhaxhit! — Lashë telefonin, që po më përcëllonte dorën, dhe u ngrita, kur dera trokiti përsëri.

— Hyrë! — Hyri shefi i administratës.

— Shpresoj se i dashuri drejtor do të më presë për t'i dhënë urimet e mia me rastin e emërimit të tij në postin më të lartë të ndërmarrjes tonë, — shefi u drejtua nga unë me të dy duart të zgjatura, që u munduan të shkundnin dorën time.

— Urimet tona, shoku drejtor! Lart e më lart në majat e shkëlqimit e të lavdisë! — Unë mbeta përsëri memec, ndoshta nga që nuk e kuptoja këtë lloj shqipeje, ndërsa me mendje thashë «Ku je, o reparti mekanik, se më dolli xhani!»

— Në qoftë se i shumërespektuari dhe shumë i ndershmi drejtor më lejon të largohem në krye të detyrës, unë do t'ju uroj edhe një herë: «punë të mbarë e suksese! Urime, urime, urime! Unë po shkoj.»

— Mund të shkoni! — Dera u mbyll dhe unë u përplasa në karrige: «Ku je, o reparti mekanik, ku je?» Më vinte të shkoja atje dhe jo të pastroja me pece makinerinë, po ta fshija me gishta. Më zuri koka si asnijëherë në jetën time. Pas orës një u ngrita e u nisa për në shtëpi. Ecja rrugës me një mendim: «Jo, unë kurrë nuk mund të rri drejtor. Bile vendo sa që të shkoja në Komitetin e Partisë për ankim....»

Në këto e sipër pranë meje frenoi «Varshava» nga e cila doli shpejt shoferi dhe më hapi derën:

— Më falni, shoku drejtor, se isha në mensë.

— Unë u përplasa në sedile, ndërsa shoferi zurin vendin e tij.

— Ku urdhëroni të shkoni?

— Në shtëpi! — Makina u nis. Shoferi hapi radion.

— Çfarë muzike ju pëlqen, shoku drejtor?

— Daullet e ramazanit! — Shoferi mbylli radion dhe gojën njëkohësisht.

Zbrita nga makina dhe fillova të ngjit shkallët e pallatit.

Para hyrjes në apartament trokita dhe u mbusha me frymë. Poshtë, në shesh para pallatit, kalamajtë, vallëzonin dhe këndonin njëkohësisht.

*Tunde o, drejtor, tunde
Me tapanxhe e me kobure.
Dil, moj teta Evanthy,
Se të erdhi drejtori.*

E me të vërtetë, nëna ime, që quhet Evanthy, hapi derën dhe, kur më pa që u ktheva në shtëpi më herët se ditët e tjera, u alarmua.

— Ç'ka ndodhur, bir?

— Jam pak pa qejf, nënë!

— Më ngrëntë mortja mua, kam parë edhe ca ëndrra të liga.

— Mos u merakos, nënë, më dhemb pak koka.

— Ja, po të sjell nëna aspirina. — Ajo shkoi në kuzhinë, ndërsa unë u futa në dhomë. Sa hapa derën, në komodinën time kish zënë vend telefoni dhe prapa tij, në vazo, një tufë me lule.

— Ç'është ky telefon, moj nënë?

— Dy djem e prunë, të keqen nëna. Unë i pyeta se përse e vunë, ata më thanë, «e di drejtori».

*Tunde, o drejtor, tunde
Me tapanxhe e me koburee...*

Këtë herë fëmijët ia kishin marrë labçë, sikur ta dinin që unë jam i djegur pér këngën labe. Me-gjithatë mbylla dritaren dhe u shtriva, por menjëherë u hodha përpjetë nga zilja e telefonit, që më ra në daulle të veshit, si vaj i nxehjtë.

— Alo, urdhëro!

— Konstandini je? — pyeti një zë si i njohur.

— Po.

— Kozmai jam, — foli një shoku im nga reparti mekanik...

Zëri i Kozmait qe aspirina më e fortë, që aty pér aty ma hoqi dhembjen e kokës. Shtrëngova receptorin në vesh:

— Komi, ku je, vëlla, se më duket sikur kam dhjetë vjet pa të parë!

— Harrove se sot kemi ditën e rrogës, apo u bëre drejtor edhe nuk vjen më të pish një shishe birrë me ne! — bëri shaka Kozmai. M'u mbushën sytë me lot dhe nuk flisja dot.

— E, more, pse s'flet, apo... — dhe qeshi.

— Harrova fare; Kozma, të lutem merr edhe rrogën time dhe takohemi si gjithmonë tek «Bërxolla e grasos»! — Kështu quanim ne një birrari të qytetit tonë, ku mblidhej pas pune reparti mekanik në çdo ditë rroge.

— Mirë u pafshim, Kosta!

— Mirë u pafshim Komi. — U shtriva përsëri.
Jo, kurrë nuk do të qëndroj drejtor. Koka më pushoi
fare dhe gjumi po më avitej.

— Zërrrr!

— Plaç, se më trembe. Mora receptorin. Këtë
herë vinte nga larg një zë femre.

— Alo, Konstandin? — pyeti zëri gjithë naze.
«Hej, bela, mendova, ka që edhe në telefon s'heqin
dorë nga nazet!

— Po ju, kush jeni?

— Nuk më njeh?

— Jo.

— Oh, unë e shkreta, si më paske harruar! Ah,
unë fatzeza, po si kështu, more «Kostja» i dashur,
më harrove edhe zërin, ndërsa unë do të ta dalloja
nga gjithë zërat e botës...

— Shiko, shiko! — thashë padashur.

— Nuk jam Shika, jo... Ah, unë ditëzeza!

Zëri në anën tjetër filloi të qante sa të këpuste
shpirtin, hiqte e ndillte me ngashërim, sikur «mos
o zot», të kishte rënë mbi varrin e freskët të më të
dashurit të zemrës dhe i ankohej dikujt tjetër që
kishte pranë, por që edhe mua më vinin shqeto fja-
lët e saj:

— Konstandini është bërë sikur... Për të unë e
shkreta... Oh, unë e shkreta që jam në katin e parë...
pa të më shihje si do të fluturoja nga i pesti... «Po
kjo, nuk ngjitet dot katër kate më sipër!», mendova.

— Alo, alo, — humba durimin. — Kush je, moj,
se të betohem, për kokën e nënës, nuk po të njoh.

— Mos më thuaj se nuk më njeh, shpirt... jo,
jo mos më thuaj më, se më ra të fikët... Oh, e shkreta
unë, që më harrove kaq mizorisht, harrove Zanën
tënde!..

Ja, më në fund e mora vesh se qe Zana, së cilës para dy vjetëve i kisha shfaqur dashurinë time, dhe ajo, që nga universiteti, e kishte shkelur me takat e gjera të modës... Gjaku më hipi në tru. Përplasa receptorin e telefonit dhe e shkula nga priza. Në këtë kohë u dha nëna te dera me një shportë me vezë në dorë.

— Ç'i ke ato vezë?

— I pruri dikush, t'u bëftë nëna. Këto janë për drejtorin, tha.

— Po tjetër, ç'tha?

— Bëji të fala tha... po e di ç'ke ti, xhan i nënës, pa merri këto vezë dhe çoja drejtorit tënd, se është amaneti i botës.

— Drejtori është transferuar në Tiranë.

— Po tani, mor bir, si do të vejë filli i kësaj pune, apo do t'ia dërgosh atje?

— Jo, do t'i mbajmë ne, — i thashë, duke e parë drejt në sy.

— Neee! — u çudit ajo. — Jo, bir, kjo është djersë e botës. Unë kam djersën time.

— Vetë the që i solli për drejtorin, apo jo?

— Po.

— Shumë mirë. Drejtor jam unë tani.

Plaka përplasi dy tre herë qepallat dhe më shikoi me dyshim:

— Mos ke zjarrllëk, bir, që po flet përcart?

— Më zgjodhën mua drejtor, nënë.

Ajo nuk mundi të nxjerrë asnjë fjalë nga goja, pastaj e mblođhi veten.

— Më dukesh se po tallesh me mua plakën, ti?!

— Të betohem, nënë, që më bënë drejtor.

Tani plakës i shpëtoi nga dora shporta me vezë
dhe i ra me zhurmë në çimento.

• • •

*Dil, moj teta Ewanthi,
Se të erdhi drejtori...*

Aty nga ora gjashtë e darkës zbrita shkallët e apartamentit. Sa dola në krye të pallatit, kalamajtë lanë lojën dhe po më shikonin, sikur të mos më kishin parë prej vjetësh.

— Do ta nisim një me porta të vogla? — u thashë si zakonisht. Ata nuk u përgjigjën, po u munduan të fshiheshin pas njëri-tjetrit.

— Hëni, more, apo nuk jeni në formë sot! — i nxita...

Përsëri asnjë nuk u përgjigj. Vetëm një prej fëmijëve nxori kokën pas kurrizit të shokut dhe pyeti:

— Pse, luan futboll me kalamanj drejtori?

— Si ore nuk luan futboll drejtori? Bile ka ndonjë drejtor, megjithëse shumë rrallë, që luan edhe si pelivan...

Te këmbët e mia frenoi «Varshava». Shoferi zbriti.

— Ç'ka ndodhur?

— Asgjë, erdha se mos...

— Çoje makinën në ndërmarrje.

Shoferi u nis pa qejf.

Shokët i gjeta, si gjithmonë, tek «Bërxolla e graso». Ata kishin bashkuar tri tavolina dhe po prisin. Në mes tyre harrova telashet e ditës. Megjithatë

ndonjëherë bija në mendime. Po ku të linte Kozmai!

— Emo, shokëni. Pa shikojeni mirë Konstandinin. E ka marrë a s'e ka marrë nurin e drejtorit? — dhe më shikonte sikur të isha model piktori. Të tjerët qeshnin. Bashkë me ta më rrëmbente edhe mua ai gaz shoqëror që më ngrohte. Kur mbushëm gotat me birrë, Kozmai, si më i gojës, u ngrit në këmbë dhe nisi të ligjërojë.

— Ta ngremë këtë gotë për t'i uruar shokut Konstandin punë të mbarë dhe suksese në detyrën e re. Le ta kemi midis nesh gjithmonë të nderuar e të respektuar!

— Hajde, gëzuar e suksese!
— Gëzuar e t'i hamë dasmën.
— Më parë të gjejë një nuse.
— Po jo nga ato që gjuajnë doktora, inxhiniera e drejtora.

— Larg qoftë, hajde, gëzuar!...
— Mua m'u kujtua biseda në telefon me Zanën. Po shportën me vezë kush e dërgoi? Përsëri më push-tuan mendimet.

Zana e përlotur... pastaj shporta me vezë... Zana duke qarë, vezët e thyera. Një kaos mendimesh, të ngatërruara a ndoshta edhe birra, më kishin veçuar nga humor i shokëve, të cilëve u ra në sy menjëherë.

— E, more, mblidhe, se nuk të marton njeri me zor! S'do të martohesh rri, mbyllu në «Varshavë». — Altini ngriti gotën në anën tjetër të tavolinës. Unë qesha me zor.

— Më dukesh pa qejf sonte Konstandin! — Kozmai më pa drejt në sy...
— Jo, s'kam gjë! — ula sytë unë. «Po sikur t'ua tregoje brengën tënde shokëve — mendova. — Jo,

nuk është rasti as vendi», — hoqa dorë nga ai mendim.

Në fund, kur u larguam, munda t'ia them të gjitha Kozmait, të cilin e kemi edhe sekretar partie të ndërmarrjes. Ai, si dëgjoi me vëmendje, më tha:

— Byroja e organizatës bazë të Partisë nuk e ka aprovuar largimin e shokut Selam, për këtë byroja ka marrë vendim që ai t'i nënështrohet njëherë mendimit të kolektivit. Nuk më vjen mirë që thua se do të largohesh nga detyra. Partia dhe kolektivi ka besim te ti. Jo vetëm ka besim, por edhe të mbështet fuqimisht. Tërheqja nuk është cilësi e komunistit, prandaj përpara, vetëm përpara, me guxim. — Kozmai më ngrohu pak. Tani mendimet e zymta përplasheshin me fjalët e tij, me mendimet inkurajuese të sekretarit të organizatës bazë të Partisë.

— Mirë, po dua të më plotësoni edhe një kusht!

— Çfarë kushti kërkon? — pyeti ai me interesim.

— S'kam nevojë për shofer, gjersa mbaj edhe patentën e naftës. Edhe makinën do ta marrë rrallë për rrugë të gjata dhe urgjente!

— Ja ç'do të thotë shok klase! Kurse ndonjë tjetër nuk lë gur pa lëvizur për një shofer dhe për një veturë. Mirë, besoj se do ta plotësojmë këtë kusht, shok i dashur.

DITA E DYTË

Të nesërmen, domethënë ditën e dytë të drejtortllëkut, sa u ula në karrige, trokiti dera.

— Ju jeni drejtori? — pyeti një njeri që s'e kisha parë ndonjëherë.

- Po! — Ai u fut brenda, mbylli derën me kujdes dhe u drejtua nga unë.
- Si jeni, shoku drejtor?
- Faleminderit, ju mirë?
- Jam kunati i Selimit. Para ca ditësh ju kam hedhur një letër nën derë, mbasi nuk ju gjeta. Nuk di a e keni marrë apo jo?
- Kush e dërgonte këtë letër?
- Selimi pra!
- Kujt ia dërgonte?
- Juve pra!
- Kujt juve?
- A jeni ju drejtori?
- Po.
- Shumë mirë. Letra i drejtohej shokut Selam, drejtorit të ndërmarrjes.
- Unë nuk jam Selami.
- Nuk je Selami?!... po a je drejtori?
- Ai jam.
- Atëhere je Selami.
- Mirë atëhere, sipas jush jam Selami. Ç'doni nga unë ju?
- Ja atë që shkruan Selimi, të më merrni në punë.
- Këtë gjë mund ta bëjë vetëm komiteti ekzekutiv, që e ka në kompetencë.
- Po Selimi kështu më tha.
- Selimi ka thënë për Selamin, por unë jam Konstandini. Tjetër gjë s'keni?
- Jo.
- Të mirë u pafshim! — i zgjata dorën. Edhe ai zgjati automatikisht dorën, pa folur, vetëm rrrotulloi sytë, si ajo laraska kur shikon se ia kanë prishur çerdhen. Pastaj iu drejtua derës.

Sa u mbyll, dera trokiti përsëri.

— Hyrë!

Këtë herë shefi i administratës me një dosje në sqetull u thye më dysh me derën të hapur.

— Mirëmëngjes, shoku drejtor!

— Mirëmëngjes!

— Si keni fjetur? Besoj se nuk keni fjetur mbrëmë.

— Jo, fjeta mirë.

— Po, po, ashtu do të thoni, e dija unë. Po më lejoni t'ju them, shoku drejtor, se mbrëmë ju nuk keni fjetur.

— Nga e dini këtë? — Ai qeshi shumë i kënaqur për atë që tha dhe vazhdoi:

— E para se një drejtor fle pak e mendon shumë, aq më tepër një drejtor i ri. E dyta, nuk e di, po mua më ndodh shpesh, kur fle pak në drekë nuk bëj gjumë të mirë në darkë.

— Si e morët vesh që fjeta në drekë.

Ai përsëri qeshi, lëshoi dosjen në tavolinë e u ul.

— Isha pak në drekë. Nuk më durohej pa të uruar edhe në shtëpi, më tepër për atë nënën, që të ka rritur... eh! Ti je i vogël, po unë e di mirë si të ka rritur ajo...

«Doli edhe i zoti i shportës», mendova.

— Ju e prutë shportën me vezë.

— Ehe, gjë e vogël...

— Sa bëjnë ato? — e pyeta.

— Asgjë, asgjë, — u nxitua ai. — Mua m'i solli kunati nga Peqini.

— Po ai i ka sjellur për ju dhe jo për mua.

— Ashtu vërtet, por ai mua e unë juve, kështu e kanë këto punë... Nxora lekët dhe ia flaka me përbuzje.

— Merrni paratë, dhe në qoftë se e përsëritni keni të tjera avaze. Ai u step, sikur unë të mos i kisha hedhur lekë, por një granatë.

— Më falni, shoku drejtor, por unë... unë kisha vetëm qëllime të pastra.

I tregova derën. Ai u ngrit i dërrmuar dhe doli, duke mërmëritur, s'di çfarë.

Kaluan nja dhjetë minuta pa më shqetësuar njëri, bile edhe telefoni heshtte. Po kjo qe një qetësi si ajo që ndodh para se të shpërthejë rrebeshi. E me të vërtetë rrebeshi erdhi. Por për çudi ky rrebesch mua më largoi nga telashet e drejtorit dhe më çoi atje në repartin tim mekanik...

Dera u hap me zhurmë, pa trokitur. Altini kishte marrë flakë.

— Kësaj i thonë maskarallëk, për nder. Do të vini dorë, apo të shkoj në Komitetin e Partisë.

— Mirë se erdhe njëherë! — Unë i zgjata dorën. Ai buzëqeshi i zënë në faj.

— Urime për detyrën, se.. na luajtën mendsh.

— Zgjati dorën e tij të madhe dhe ma shtrëngoi si me morsetë.

— Ç'pate, Altin? Ti s'para nevrikosesh kollaj.

— Si të mos nevrikosem, shoku Konstandin! Kanë ardhur nga uzina rajonale me një makinë cimento dhe duan të bëjnë allishverish me ca pjesë këmbimi, që ne po i ruajmë si ujët e paktë në gusht...

— Në asnjë mënyrë! — ia preva fjalën.

— Si?! Nuk keni dhënë urdhër ju?!

— Jo.

— Ashtu!.... — Altini u kthyesh dhe u zhduk si furtunë, ashtu siç kishte ardhur. U ngrita edhe unë për ta pasuar, por më zuri derën një xhaxho.

— Të zura! — Ai më vuri bastunin, si postbllok

përpara, pastaj çoi bastunin dhe hejbetë dhe më përfshiu në krahët e tij, më rrasi mustaqet e bollshme në gojë, duke më puthur kështu, sikur të më kishte më të dhimbsurin e zemrës. Kishte shumë vjet pa më parë.

— Si të ka xhaxhai ty, more kapedan, po si je, more asllan? Ah! qerrata ç'nur ke marrë, tamam drejtor! Emri i zotit, drejtor me halle... Pa dale të të puth edhe një herë xhaxhai!... Edhe një herë mustaqet e xhaxhait u ngjeshën si shtupë në gojën time.

— Lart e më lart, djali i xhaxhait! Më gëzon zemra, se jemi gjak e gjaku nuk bëhet ujë...

Megjithëse nga mustaqet u çlirova, krahët e tij më mbanin ende të shtrënguar në gjoks. Dhe ndoshta do të kisha mbetur edhe për një kohë më të gjatë ashtu, veç doli një bibë pate nga hejbet e plakut, duke klithur me lemeri, me përplasje krahësh kaq të forta, sa që shkresat fluturan në tavan. «Xhaxhai» më lëshoi dhe iu qep bibës, që u fut nën tavolinë. Zgjati bastunin, po ajo u largua më tej, gjithnjë me zhurmë e klithje. Plaku doli nga ana tjetër, por ajo me ndihmën e krahëve, se këmbët i kishte të lidhura, erdhi gjer tek këmbët e mia.

— Zëre! — thirri plaku. Zëre lanetin! — U hodh vetë për ta kapur. Këtë herë nuk shkoi bosh. E kapi bibën nga njëri krah dhe e futi në hejbe.

— Këtu, moj qorre, këtu rri, pa në mbrëmje ta rregulloj unë në shtëpinë e drejtorit. Në tavë, me oriz e kopër, ja si do të rregulloj unë. Po s'besove ja dhe «lulushanen» e kam marrë me vete. Në këtë kohë nxori një shishe litërshe nga sythi tjetër i hejbes.

— Rrush, pa hile. E kam zier vetë për merak,

ashtu si për drejtor. — Ai më zgjati shishen. — Provoje një herë, pa do të shikosh ç'raki mban xhaxhai.

— Faleminderit, nuk e pi.

— Shumë mirë bën, se s'ka lezet të pijë raki një drejtor në zyrë. — Plaku e futi shishen në hejbe, dhe i hodhi në krah.

— Ika, kapedani i xhaxhait, ika në shtëpi. Sa të mbarosh punë ti, — më rrahu miqësish shpatullat. — Kështu djali i xhaxhait. Këtë kemi gjëzim ne. Kur jeni mirë ju, jemi dhe ne. Hajt, mirë ardhsh! Plaku u nis pa më dhënë dorën, gjë që donte të thoshte se do të takoheshim së shpejti. Biba e patës kishte nxjerrë kokën nga sythi i hejbeve dhe e lëkundte nën ritmin e hapave të gjatë të plakut, sikur po i jepte lamtumirën e fundit kësaj bote, nga do të bëhej kurban për një drejtor.

DITA E TRETË

Sa zbrita nga makina, rashë në krahët e drejtor Selamit. Dy buzë të buhavitura u rrasën mbi të miat. Era e konjakut më zuri frymën. «Të keqen e mustaqeve të «xhaxhait» mendova.

— Hë, s'kishin besim, kur u thashë: «Bëni, more drejtor Konstantinin, që s'e ka shokun, për punë a, për sjellje, organizim, pikë e djalit, kuadër i vërtetë, për nder që ka burri, kështu u thashë. — Selami më përfshiu përsëri në krahët e tij. Pëllëmbët gjithë tul rrini me forcë shpatullat e mia.

— Urime dhe suksese në detyrën e shenjtë të drejtorit! Lart e më lart. Do të bësh përparrë. Dëgjomë mua. I thashë edhe shokut Myslim në ministri! Është ajka e kuadrit që vjen nga klasa punëtore.

Tani kisha shpëtuar nga duart e tij. Ato qenë futur në xhepat e pantallonave, sikur donin të qetësoheshin mbas asaj furtune përqafimi. Barku i rrumbullaktë e i bëshëm dukej kërcënues nën jelek.

— Po ç'kemi? Si shkojnë punët? — pyeti.

— Çka!

— Fillimi është i vështirë. Sa t'ia marrësh dorën. Veç duhet ta dredhësh! — dhe më luajti syrin drejtore Selami. — Emo, se të mëson vetë karrigia.

— S'të marr vesh!

— Hë, qerrata, se do t'i mësosh marifetet, por... more, nuk di përsë bëhet ajo mbledhja e kolektivit sot?

— Ka halle ndërmarrja! — i thashë.

— Halle?! Po ka dhe një drejtore me «halle»,

— më rrahu përsëri shpatullat ai.

Në mbledhje punëtorët ia numëruan një për një shkoqur e shqeto «gjynahet» Selamit, gjë që e kishin bërë edhe më përpara herë pas here. Veç ai kishte shkarë me marifete që rrallë se i di kush tjetër. Këtë radhë gjatë gjithë diskutimeve, ai herë mblidhë supat si fort i çuditur, herë buzëqeshteëmbël në drejtim të folësit, sikur ai të mos e kritikonte, por ta propozonte për më lart. Pra Selamit i thoshte tepeleku se bënte pjesë në atë skotë njerëzish që gjithmonë del pa lagur fare. Shpeshherë, me lojëra fjalësh, ai i largohej me finokllëk thelbit të problemit, duke u kapur nga degët si një majmun i stërvitur mirë. Mirë po këtë radhë qe mbushur kupa dhe pelivanllëkeve të tij iu pat ardhur fundi.

Sallën e madhe të mensës e pushtoi qetësia. Pastaj fjala e Selamit, ose më saktë, pritej të jepte hesap një për një. Dhe ai u ngrit, ashtu i qeshur dhe ia nisi.

— Shokë e shoqe, vëllezër e motra! Jam shumë i emocionuar, prandaj edhe në qoftë se konstatoni ndonjë lajthitje, mos ma vini re, se unë, si gjithherë, do të flas me zemër në dorë, ashtu siç folët edhe juve pak më parë, me atë pastërtinë punëtore dhe me drejtësinë e shenjtë të klasës. Shpeshherë them, ç'do të ndodhte me ne kalemxhinjtë në qoftë se largohemi sadopak nga ju?

— Afrohuni, shoku Selam, — tha një nga punëtorët.

— Nuk më dëgjoni? — u «keqkuptua» Selami dhe ngriti zërin më lart. — Thashë nuk e di ç'do të ndodhte në qoftë se do të shkëputeshë nga ju, punëtorët.

— Ta them unë, shoku Selam, — u ngrit po ai punëtor që foli më parë. — Do të punonit së bashku me ne, gjer sa të mësonit se ai që shkëputet nga klasa punëtore nuk i shërben më asaj.

— Hë, më të lumtë shok! — e miratoi Selami dhe vazhdoi: — Kjo është fjalë me mend, shokë. Dhe zaten ju, punëtorët, në çdo situatë e tregoni pjekurinë tuaj.

— Dhe ju s'po mbeteni pas — thumboi njëri.

— Një çikë rregull, shokë! Mos i prisni fjalën — tha sekretari i Partisë, që drejtonte mbledhjen.

— Ju, shokë, më kritikuat se këtu në ndërmarrjen tonë kanë ndodhur... si të them... ca gjëra... ca gabime që nuk duhej të ndodhnin. Ashtu është. Edhe unë jam i një mendjeje me juve, vetëm mos harroni se në një ndërmarrje të madhe këto të meta janë të meta të rritjes, të ecjes... Pra, ne kemi ecur, nuk kemi qëndruar në vend. Unë, siç e dini, jam përpjekur për...

— Tarafllek! — ia preu fjalën Altini.

Selamit i ngriu buzëqeshja në fytyrë, si një film që këputet.

— Tregohuni më i qetë! — tha sekretari i Partisë.

— Më falni, shoku Kozma, në qoftë se gabova, vetëm dua ta pyes shokun Selam. A nuk është e vërtetë se jeni baxhanak me shefin e administratës?

— Jam.

— Po shoferin e «Varshavës» e keni kushëri të parë?

— Po.

— Selimenë e keni krushkë?

— Krushkë e kam. Pse, si thoni ju, ta prishim krushqinë?

— Përkundrazi, po jo ama në kurriz të ndërmarrjes e të shtetit.

Selami ngriti grushtin, por e mblohti menjëherë, fërkoi ballin e djersitur dhe diç mërmëriti.

— Shefin e furnizimit e keni kunat, apo jo?

— Po.

— A nuk i thonë këtij taraf me brirë?

Selami ngeli për një hop, pastaj diçka i ndriti në kokë.

— Po shefin e administratës unë s'e kam asgjë!

— fytyra i qeshi.

— E ke! — u dëgjuia një zë.

— Shefin e administratës? — u çudit shumë Selami, meqë në të vërtetë s'kish të bënte me të.

— Pikërisht atë! — Fliste një axhustator, moshatar i Selamit.

— Shefin e administratës e kam unë farefis?!

— Jo farefis.

— Po atëhere?

— Është hija juaj.

— Flisni më shkoqur.

— Ta shkoq kokërr më kokërr. A mund ta mohoni se në çdo javë ju hani një darkë te shoku shef? A mund të mohoni përsëri se pothuajse çdo ditë ia shtroni në pijetore me të dhe kur vjen puna për të paguar asnjëherë s'e keni kruajtur xhepin?

— Kockën i ka grënë, a derëbardhë. — S'di kush foli një nga punëtorët e moshuar.

— Pra nuk hyn ky në tarafllëk, në «sektorin» e qylit?

Tani mendova se Selami do të dorëzohej pa kushte. Por ai me të vërtetë qe kockë e fortë. Tundi kokën, në gjysmë miratim, ngriti dorën me dy gishërinjtë para:

— Dy milion jemi, o vëllezër, dy. Të dy këta milion janë mpleksur me krushqi e farefis, apo jo?

— Më fal, more shoku Selam, po në ndërmarrjet e tjera mos jemi dyqind milion? Sepse në ndërmarrjet e tjera s'kemi parë e dëgjuar hynere si këto të tuat. — Plasi shamata e gazi. Në këtë kohë ndërhyri sekretari i Partisë.

— Qetësi, shokë! Mos i prisni fjalën shokut Selam!

Mirëpo Selamit tani i qe shthurur lëmshi keq dhe u desh një copë herë ta merrte veten.

— Unë nuk po them se s'kam bërë gabime, se në fund të fundit edhe unë njeri si ju jam, vetëm... vetëm. Dua të them se ju po hidhni poshtë gjithë punën time. Mos harroni se më kanë rënë këmbët për të siguruar çdo gjë që ndërmarrja të vazhdonte punën normalisht.

— Pse nuk thua se ke bërë allëshverishe? — pyeti një nga punonjësit e furnizimit.

— Allishverishe?! — ngriti vetullat Selami. Unë

kam marrë materiale që na duheshin nga ndërmarrjet e tjera. Me një fjalë nga shteti në shtet, nga ndërmarrja në ndërmarrje, po për të mirën e ndërmarrjes. Këtu më duket nuk ka ndonjë shkelje ose allishverish, siç thoni ju, apo jo?

— Po! Keni të drejtë, — tha Altini. — Edhe unë i bëj një propozim kolektivit mbi bazën e «arsyetimeve» tuaj.

Selami po shikonte me gojëhapur.

— Shokë, unë propozoj që shoku Selam të punojë në axhusteri në vend të Konstandinit. Me një fjalë «një allishverish» nga ndërmarrja në ndërmarrje, për të mirën e punës, për të mirën e ndërmarrjes. Jeni dakord?

Të gjithë e miratuan propozimin e Altinit, ndërsa Selami u ul e nxori shaminë të fshinte djersët.

P E R M B A J T J A

Faqe

E po... gëzuar o krushk!	3
Si desh u sëmura	10
Pritja e krushkut	18
Përse kërcet karrikja?	23
Varianti «sallatë»	29
Ku më ke, moj xhan	36
«Ustallarët» e kulturës	41
I «arratisuri»	47
Të rruat blloku, shoku brigadier	53
A i bihet plepit me kokë?	59
Zhabaxhinjtë	64
Një herë vdes njeriu	70
Zanati lihet me shpirtin	77
Letër	84
Fqinjët në garë	88
Shërbimi i barkut	93
Sa kushton një shtëpi?	99
Të pimë një kafe	102
Ballë pér ballë	105
Kur më zuri sevdaja	111
Tri ditët e para të drejtorllékut	116

